



USHTRIA



Viti i 69-të i botimit Nr. 43 (82644)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 6 nëntor 2015

ZHVILLOHET CEREMONIA E HAPJES SË VITIT AKADEMIK 2015-2016



Në sallën e auditoriumit të Ministrisë së Mbrojtjes është zhvilluar ceremonia e hapjes së vitit të ri akademik 2015-2016. Ishte e pranishme ministria e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA-së, gjeneralmajor Jeronim Bazo, drejtorë dhe ushtarakë të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm, stafi pedagogjik i Akademisë së Forcave të Armatosura, studentë dhe kursantë që sapo kanë nisur kurse të ndryshme pranë këtij institucioni ush-

taraketj. Fjalën e hapjes e mbajti zv.komandanti i Doktrinës dhe Stërvitjes, kolonel Ruzhdi Kuçi. Ministria e Mbrojtjes Kodheli në përshëndetjen që mbajti me këtë rast theksoi se, tashmë mbas dy vitesh sistemi ynë arsimor po i rikthehet lavdisë së viteve më përpara, ai është baza nga ku nisët çdo sukses i ushtarakëve të çdo karrieret. Ndaj sot në mënyrë të veçantë jam krejt e lumtur dhe besimplotë se ky ndryshim...

» faqe 3

Bashkëpunimi me pushtetin vendor faktor i rëndësishëm në suksesin e stërvitjes "Rreth-Grethi 2015"

» faqe 3

FORCAT E ARMATOSURA

Hapa të tjerë drejt modernizimit

Forcës Ajrore i shtohen dy helikopterë të rinj për operacionet SAR, ndërsa katër mjete të blinduara i shtohen Policisë Ushtarake



» faqe 2



"Trident Juncture 15"

Trupat shqiptare në Sardenja të barabartë me homologët e tyre të Aleancës

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Jeronim Bazo, inspektoi trupat shqiptare në stërvitjen e NATO-s "Trident Juncture 15", në Sardenja, Itali. Kompania e Parë e Këmbësorisë e b2k të Forcës Tokësore, e cila po zhvillon stërvitjen në Sardenjë të Italisë...

» faqe 4




Rreth çështjes së luftës

Flasin studentët e Kursit të Lartë të Oficerit në AFA

Përpjekjet për të ofruar një kuptim të marrëdhënieve ndërmjet fitimit të luftës dhe krijimit të shtetit në botë janë ndërmarrë nga shumë studiues të Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Studimeve Strategjike. Në shumicën e këtyre përpjekjeve vëmendja...

» faqe 7



ANALIZE

Perspektiva gjinore në Forcat e Sigursë dhe Mbrojtjes Kombëtare Afgane

» faqe 8-9

INTERVISTA

Sportistë të mëdhenj dhe bashkëshortë të pandarë

faqe 10-11

NATO/ TRANSPARENCË DHE PARASHIKUESHMËRI

"Trident Juncture 2015" e hapur për vëzhguesit ndërkombëtarë

faqe 14

Hapa të tjerë drejt modernizimit të Forcave të Armatosura

Forcës Ajrore i shtohen dy helikopterë të rinj për operacionet SAR (kërkim-shpëtim), ndërsa katër mjete të blinduara i shtohen Policisë Ushtarake

Në Bazën Ajrore në Farkë është zhvilluar ceremonia e dorëzimit të dy helikopterëve të rinj të tipit EC-145 në konfigurimin SAR (kërkim-shpëtim), si dhe katër mjeteve të blinduara të klasit "Lince" për Policinë Ushtarake. Ishin të pranishëm ministria e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA-së, gjeneralmajor Jeronim Bazo, komandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade Vladimir Avdia, ambasadori i Republikës së Francës në Tiranë, z. Bernard Fitoussi, i ngarkuari me punë i Italisë Marcello Cavalcaselle, atashë ushtarakë të akredituar në vendin tonë etj.

Ministria e Mbrojtjes Kodheli, duke përshëndetur në këtë ceremoni, tha se përfundimi i programit të modernizimit të Forcës Ajrore me gjashtë helikopterët, të cilët operojnë me të njëjtat standarde si në ushtritë e Aleancës, si dhe me përgatitjen e pilotëve dhe teknikëve pranë kompanive me prestigj në fushën e fluturimit, do të bëjë që Forca jonë Ajrore të jetë një vlerë e shtuar, jo vetëm për garantimin dhe rritjen e sigurisë dhe cilësisë së shërbimeve ajrore brenda vendit, por në të njëjtën kohë ne do të kemi mundësi që të kryejmë operacione të përbashkëta në bashkëpunim me komandat e NATO-s për t'i dhënë zgjidhje situatave të ndryshme. Ndërkaq, znj. Kodheli vlerësoi edhe fuqizimin e Policisë Ushtarake me katër mjete të blinduara të klasës "Lince". Këto mjete, theksoi ajo, do të shërbejnë për të rritur kapacitetet teknike dhe operacionale të misionit dhe detyrave të Policisë Ushtarake, si dhe për të zhvilluar, kompletuar dhe rritur nivelin operacional të kësaj strukture për kryerjen e operacioneve të vështira në zona me rrezikshmëri të lartë e më gjërë.

Me këtë rast, ministria Kodheli ka falënderuar mbështetjen e aleatëve dhe miqve tanë të Francës, Gjermanisë dhe Italisë, por edhe të gjithë përfaqësuesit dhe trajnuesit e vendeve mike.



Fjala e ministres së Mbrojtjes Kodheli

*Të nderuar ambasadorë,
I nderuar gjeneral Bazo,
Të nderuar gjeneralë, ushtarakë,*

Të nderuar pjesëmarrës,
Kam kënaqësinë e veçantë të jem sot e pranishme në këtë ceremoni që përkon me ardhjen e dy helikopterëve të gjeneratës së fundit model EC 145 në konfigurimin SAR (kërkim shpëtim), por dhe me kompletimin e Policisë Ushtarake me mjete të blinduara. Me ardhjen e këtyre dy helikopterëve Flota Ajrore e Forcave të Armatosura pasurohet dhe modernizohet duke rritur ndjeshëm kapacitetet operacionale. Që sot Komanda e Forcës Ajrore ka në përdorim 4 helikopterë Cougar AS532AL, në konfigurimet SAR (Search dhe Rescue), MEDEVAC (Medical Evacuation) dhe TTH (Transport Trupash); si dhe 2 helikopterë EC145, në konfigurimin SAR.

Modernizimi i Forcës Ajrore shqiptare me këta helikopterë i jep mundësi Forcës tonë Ajrore të kryejë operacione të ndryshme dhe misione të vështira, pavarësisht kushteve meteorologjike, ditën apo natën, në operacione luftarake, si dhe në mbështetje të Forcave Tokësore dhe atyre Detare. Me modernizimin e Forcës Ajrore me këta helikopterë synohet të rritet shkalla e operacionalitetit, pasi kjo teknikë është e paisur me paketë modern, e cila përfshin sistemet e navigimit satelitor, instrumente tërësisht dixhitalë dhe



në të njëjtën kohë garanton siguri maksimale për pilotët dhe pasagjerët edhe për shkak të pasijes së tyre me dy motorrë.

Përveç përkujdesjes për paisjen me helikopterë nga më modernët dhe më të sigurtët, Ministria e Mbrojtjes, Shtabi i Përgjithshëm dhe Forcat Ajrore janë kujdesur për trajnimin sipas standardeve më bashkëkohore të NATO-s për personelin që do të

operojë me këta helikopterë.

Të nderuar pjesëmarrës,
Përfundimi i programit të modernizimit të FA me gjashtë helikopterët, të cilët operojnë me të njëjtat standarde si në ushtritë e Aleancës, si dhe me përgatitjen e pilotëve dhe teknikëve pranë kompanive me prestigj në fushën e fluturimit, do të bëjë që Forca jonë Ajrore të jetë një vlerë e shtuar, jo vetëm për garantimin dhe rritjen e sigurisë dhe

Kodheli: Kam besim të palëkundur se efektivat e Forcës Ajrore dhe të Policisë Ushtarake do të vijnë të mbajnë lart emrin dhe punën e tyre me profesionalizmin dhe përkushtimin që i ka karakterizuar gjithmonë në përmbushjen e misionit tonë fisnik

cilësisë së shërbimeve ajrore brenda vendit, por në të njëjtën kohë ne do të kemi mundësi që të kryejmë operacione të përbashkëta në bashkëpunim me komandat e NATO-s për t'i dhënë zgjidhje situatave të ndryshme.

Ndërkaq, siç e thashë dhe më lart, Policisë Ushtarake tashmë i vihen në dispozicion katër mjete të blinduara të klasës "Lince". Këto mjete do të shërbejnë për të rritur kapacitetet teknike dhe operacionale të misionit dhe detyrave të Policisë Ushtarake, si dhe për të zhvilluar, kompletuar dhe rritur nivelin operacional të kësaj strukture për kryerjen e operacioneve të vështira në zona me rrezikshmëri të lartë e më gjërë. Toga NRF deri më sot është ishte e pajisur me mjetet e blinduara IVECO PROTEDO, zëvendësimi i tyre me një gjeneratë të re rrit operacionalitetin e veprimeve

ushtarake me aleatët. Të lehta në përdorim me një fuqi të madhe motorrike, "Lince"-t. e reja garantojnë lehtësira dhe siguri për drejtuesin dhe personelin gjatë kryerjes së detyrave operacionale.

Në këtë ceremoni dëshiroj të falënderoj mbështetjen e aleatëve dhe miqve tanë të Francës, Gjermanisë dhe Italisë, por edhe të gjithë përfaqësuesit dhe trajnuesit e vendeve mike, të cilët kontribuan në përmbushjen e kontratës së paisjes së Forcës tonë Ajrore dhe Policisë Ushtarake me këtë teknikë moderne. Ju uroj gjithashtu gjithë pilotëve dhe ushtarakëve shqiptarë që do të shërbejnë dhe pilotojnë me këto mjete moderne, punë të mbarë në përmbushjen e detyrimeve tona, sa kushtetuese, aq edhe si anëtar i NATO-s.

Sot po kalojme kohë të vështira, kërcënime që vijnë si nga kufijtë jugor dhe lindor të NATO-s, ndaj dëshiroj dhe një herë t'ju inkurajoj dhe të kërkoj nga të gjithë ju të mos ndaleni asnjëherë së punuari në kërkim të rezultateve maksimale në përgatitjen tuaj, si dhe në rezultatet e të gjithëve ne së bashku. Kam besim të palëkundur se efektivat e Forcës Ajrore dhe të Policisë Ushtarake do të vijnë të mbajnë lart emrin dhe punën e tyre në çdo kohë dhe situatë me profesionalizmin që i ka karakterizuar gjithmonë, me përkushtimin që i ka karakterizuar në përmbushjen e misionit tonë fisnik

Ju faleminderit dhe suksese!

Zhvillohet ceremonia e hapjes së vitit akademik 2015-2016

Ministrja Kodheli: Përgatitja edhe hartimi i currikulave të reja mësimorë në Akademi dhe institucione të tjera janë sot të njësuar me ata të kurseve të vendeve perëndimore të NATO-s

Në sallën e auditoriumit të Ministrisë së Mbrojtjes është zhvilluar ceremonia e hapjes së vitit të ri akademik 2015-2016. Ishte e pranishme ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA-së, gjeneralmajor Jeronim Bazo, drejtorë dhe ushtarakë të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm, stafii pedagogjik i Akademisë së Forcave të Armatosura, studentët dhe kursantët që sapo kanë nisur kurse të ndryshme pranë këtij insitucioni ushtarakë etj.

Fjalën e hapjes e mbajti zv.komandanti i Doktrinës dhe Stërvitjes, kolonel Ruzhdi Kuçi. Ministrja e Mbrojtjes Kodheli në përshëndetjen që mbajti me këtë rast theksoi se, tashmë mbas dy vitesh sistemi ynë arsimor po i rikthehet lavdisë së viteve më përpara, ai është baza nga ku nisët çdo sukses i ushtarakëve të çdo karrieret. Ndaj sot në mënyrë të veçantë jam krejt e lumtur dhe besimplotë se ky ndryshim që bëjmë në sistemin tonë të arsimit dhe edukimit profesional do të ketë rezultatet dhe frytet e veta, të cilat po ndihen sot ashtu siç do të ndihen më shumë vite më mbrapa. “Sot kemi miratuar konceptin e arsimit profesional ushtarak në një filozofi të re në përputhje të plotë me edukimin profesional ushtarak të vendeve të NATO-s, si dokumenti themelor dhe kushtetuta e arsimit profesional ushtarak. Përgatitja e dhe hartimi i currikulave të reja mësimorë në Akademi dhe institucione të tjera janë sot të njësuar me ata të kurseve të vendeve perëndimore të NATO-s, por edhe përgatitja e Librit Stërvitor ishte një tjetër arritje të cilën ne duhet ta përmëdim me krenari në këtë ditë hapjeje” - u shpreh ministrja Kodheli.

Si rezultat i këtyre masave, vijoi më tej ajo, mund të përmend disa ndryshime të qenësishme, cilësore dhe sasiore që ndodhin dhe do të ndodhin në sistemin tonë të arsimit. Në të gjitha institucionet e KDS arsimohen dhe trajnohen sot një përsosmëri me mbi 2410 vetë, ose më shumë se 25% e të gjithë efektivit të FA, duke qenë në të njëjtin nivel me vendet e NATO-s, ku rreth 30

për qind e personelit kalon në kurse të ndryshme trajnimit brenda vitit. Një gjë e tillë është dëshmi e kapacitetit dhe aftësisë së FA-së për të trajnuar, edukuar dhe freskuar personelin e saj në interes të realizimit të misionit tonë fisnik. “Të gjitha këto janë hapa të sigurtë drejt një sistemi, i cili do të mundësojë rritjen cilësore dhe profesionale të FA, pa të cilët ne nuk mund as të kryejmë misionet tona fisnike kushtetuese, detyrimet tona ligjore ndaj atdheut dhe ndaj shoqërisë tonë, as detyrat që na parashtron mbrojtja kolektive si vend i denjë i organizatës më të fuqishme politiko-ushtarake, asaj të Atlantikut të Veriut. Unë ju uroj suksese dhe shpresoj shumë që të mund të kemi mundësinë që vitin tjetër të vijmë dhe të paraqesim bashkërisht rezultate të tjera, gjithnjë e më të mira.” - përfundoi fjalën e saj ministrja e Mbrojtjes Kodheli.

Gjatë vitit akademik 2015-2016 në auditoret e AFA do të arsimohen dhe kualifikohen 109 kursantë në KLSM, KLO, KKSHP, KTHOSH (dy edicione tutor 2015, mars 2016) dhe 225 kursantë në Qendrën e Gjuhëve të Huaja, të cilët zhvillojnë kurse në anglisht, gjermanisht, frëngjisht, italisht, turqisht dhe greqisht. Pra, Akademia e FA sot punon me kapacitet të plotë duke zhvilluar të gjitha kurset e karrierës së ushtarakut, kurset e gjuhëve të huaja, si dhe ato akademike, që ndiqen nga 377 ushtarakë. Gjithashtu AFA vijon realizimin me sukses të Kursit të Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes, i cili ka filluar në datën 7 shtator 2015 me një efektiv prej 20 vetash nga FA Shqiptare, FSK, vendet e rajonit dhe institucionet e tjera të vendit tonë. Gjithashtu gjatë këtij viti akademik në Qendrën e Simulimit, në bashkëpunim me kompaninë “CUBIC”, janë planifikuar stërvitje me KLO, KKSHP, Kursin Themelor të Oficerit të Shtabit etj. E gjitha kjo punë është planifikuar në harmoni të plotë me Direktivën e ministrit të Mbrojtjes, udhëzimet e Shtabit të Përgjithshëm, Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve dhe me programet që zhvillohen për këto nivele në kolegjet respektive të vendeve të NATO-s.



Bashkëpunimi me pushtetin vendor faktor i rëndësishëm në suksesin e stërvitjes “Rreth-Grethi 2015”

Pas përfundimit me sukses të stërvitjes fushore të Batalionit të Tretë të Këmbësorisë, Poshnje, të Forcës Tokësore, të koduar “Rreth-Grethi 2015”, me një ceremoni të veçantë u bë dorëzimi i poligonit ushtarak në rajonin e Rreth - Grethit të Kavajës pushtetit vendor. Në bashkëpunim dhe në mirëkuptim të plotë me pushtetin vendor për 10 ditë rresht rreth 250 trupa të këtij batalioni u vendosën në kushte fushimi dhe zhvilluan në bazë të programit të miratuar stërvitjen fushore në zonën e Rreth-Grethit, që tashmë është nën juridiksionin e bashkisë së Rogozhinës. Fill pas përfundimit të stërvitjes, efektivi i këtij reparti kontrolloi me shumë kujdes të gjithë rajonin stërvitor, duke pas-truar të gjitha mbetjet dhe aksesorët e panevojshëm poststërvitor, nga pylli me pisha ku ishin vendosur çadrat e fushimit dhe deri në vijën bregdetare të këtij rajoni.

Komandanti i batalioni, nënkolonel Gëzim Marku, duke i konfirmuar dorëzimin e këtij poligoni stërvitor, falënderoi kryetarin e Bashkisë së Rogozhinës, z. Beqir Nuredini, për pjesëmarrjen në këtë aktivitet. Në vijim të fjalës së tij nënkolonel Marku u shpreh se një nga pikat kryesore për realizimin e programit të stërvitjes fushore “Rreth-Grethi 2015” është edhe marrëdhënia civilo-ushtarake, së cilës ne i kemi kushtuar një rëndësi shumë të veçantë. Par këtë, u shpreh ai, dua të falenderoj kryetarin e Bashkisë së Rogozhinës për bashkëpunimin që ka treguar nga momenti i zhvillimit të rikornicioneve në rajonin e fushimit dhe gjatë gjithë zhvillimit të stërvitjes sonë, ku kemi pasur një bashkëveprim dhe bashkëpunim të shkëlqyer me bashkinë dhe me të gjithë institucionet dhe strukturat e pushtetit vendor që janë të vendosur në venddislokimin ku ne zhvilluam këtë stërvitjen. Po kështu një pikë së cilës i është kushtuar rëndësi dhe ka gjetur zbatim ishte edhe mirëmbajtja e mjedisit. Këtë e nënvizoi edhe komandanti i batalionit, i cili i tha kryetarit të Bashkisë së Rogozhinës se gjatë gjithë periudhës së kryerjes së



stërvitjes, përveç realizimit të planit stërvitor, një rëndësi të veçantë i kushtuam edhe mbrojtjes së mjedisit dhe të gjithë rregullave të mirëmbajtjes së tij. “Qëllimi final i ruajtjes dhe mirëmbajtjes së mjedisit ishte që ne të lëmë pas një mjedis më të pastër nga sa e kemi gjetur. Jemi munduar që të bëjmë jo vetëm mirëmbajtjen e mjedisit ku ne jemi akomoduar dhe kemi ngritur këtë fushim, por dhe të gjithë rajoneve stërvitore, duke pas-truar gjithë mbetjet, mirëmbajtjen e pyllit, pak edhe në vijën bregdetare”. Në përfundim të fjalës së tij nënkolonel Marku u shpreh, se bashkëpunimi midis njësive që ai drejton dhe Bash-

kisë së Rogozhinës do të jetë më i mirë dhe në të ardhmen. “Falemiderit për prezencën dhe të jeni të bindur se Forcat e Armatosura do të kenë një bashkëpunim të shkëlqyer në të gjithë rajonet ku zhvillojnë stërvitje”, është shprehur nënkolonel Marku.

Ndërsa kryetari i Bashkisë së Rogozhinës, z. Beqir Nuredini, pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit në këtë aktivitet, vlerësoi punën e mirë që është bërë për bashkëpunimin e vazhdueshëm midis strukturave të pushtetit vendor me ato të Forcave të Armatosura që veprojnë në territorin e kësaj njësie vendore, duke u ndalur pecifikisht në stërvitjen 10-ditore



“Rreth-Grethi 2015” që kreu efektivi i Batalionit të Tretë të Këmbësorisë, Poshnje. Bashkia e re e Rogozhinës, vijoi më tej z. Nuredini, është bërë një bashki me një territor shumë më të gjerë nga ajo që ka pasur më parë, ku dhe sfidat në territorin tonë janë shumë herë më të mëdha. Në këtë këndvështrim bashkia sigurisht që do të kryer ato detyra shumë të rëndësishme që ne kemi ndaj qytetarëve. Duke folur për rëndësinë e bashkëpunimit me Ministrinë e Mbrojtjes dhe FA, kryetari i Bashkisë së Rogozhinës u shpreh: “Një bashkëpunim shumë i rëndësishëm për Bashkinë e Rogozhinës është dhe bashkëpunimi me FA shqiptare. Uroj që në të ardhmen të kemi një bashkëpunim akoma më të afërt për të gjitha këto sfida që ka territori ynë. Ashtu siç e tha dhe komandanti gjatë

stërvitjes 10-ditore ne kemi mundur të marrim masat që stërvitja juaj të kryhet në kushte optimale në raport me banorët e zonës dhe me territorin. Ju falenderoj pa masë për të gjithë punën e jashtëzakonshme që keni bërë për pastrimin e territorit ku ju keni zhvilluar stërvitjen tuaj”, u shpreh kreu i bashkisë së Rogozhinës, z. Beqir Nuredini.

Përfundimi me sukses i stërvitjes fushore “Rreth-Grethi 2015”, që u zhvillua para pak ditësh, tregoi edhe njëherë se bashkëpunimi me pushtetin vendor është dhe mbetet një faktor shumë i rëndësishëm për zhvillimin e stërvitjeve të ndryshme nga njësitë dhe repartet e Forcave tona të Armatosura. Ky bashkëpunim duhet të jetë i vazhdueshëm dhe i gjërë, duke përfshirë edhe fusha të tjera të jetës dhe veprimtarisë.

Sajmir Alija

Trupat shqiptare në Sardenja të barabartë me homologët e tyre të Aleancës

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Jeronim Bazo, inspektoi trupat shqiptare në stërvitjen e NATO-s “Trident Juncture 15”, në Sardenja, Itali

Kompania e Parë e Këmbësorisë e b2k të Forcës Tokësore, e cila po zhvillon stërvitjen në Sardenjë të Italisë këto ditë ka intensifikuar dhe rritur më shumë nivelin e përgatitjes së saj. Kështu në datat 28 dhe 30 tetor efektivit shqiptar ka zhvilluar qitje luftarake si pjesë e batalionit italian dhe më vete. Në këtë qitje janë përdorur dhe armët e artilerisë, mortaja 120mm, dy avion F 16, si dhe helikopterë. Në përbërje të batalionit kompania jonë ka kryer detyrën e një reparti mësymës ku ka dalë dhe një herë në dukje përgatitja e trupave shqiptare, si në shfrytëzimin e terrenit ashtu dhe në rezultatet në qitje luftarake. Realizimi i detyrës në mësymje duke kryer qitje me fisheke luftarakë, për efektivin e kompanisë shqiptare ishte një sfidë më vete, kjo për vetë specifikat e luftimit mësymës, duke filluar që nga mënyra e mbajtjes së armës dhe zbatimi i rregullave të sigurimit teknik gjatë lëzjes për zënie e vijave të detyrës, ruajtja e distancës nga njëri-tjetri për të evituar goditjet aksidentale, zgjedhja e objektivit dhe realizimi i qitjes etj. Në përfundim të kësaj stërvitje u zhvillua një ceremoni ku ishin të pranishëm Kryetari i Komitetit të Mbrojtjes së NATO-s, gjeneral Knud Bartles, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA Italiane, gjeneral Klaudio Graciano, ushtarakë të lartë të NATO-s, si dhe deputetë të parlamentit europian dhe atij italian.



Të gjithë përfaqësuesit e lartë folën më superlativa dhe pa fshehur habinë për nivelin e lartë të përgatitjes, përkushtimit dhe disiplinës së trupave shqiptare. Zhvillimin e stërvitjes së trupave tona më datë 2 nëntor 2015 e inspektoi dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA-së, gjeneralmajor Jeronim Bazo dhe ushtarakë të tjerë të lartë shqiptar. Gjatë këtij inspektimi, përkrah gjeneralmajor Bazos, ishin të pranishëm dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm Italian, gjeneral Klaudio Graziano dhe komandanti i JFC Brunssum, gjeneralmajor Hans-Lothar Domrose. Stërvitja kishte në fokus rritjen e ndërveprueshmërisë së

trupave në fushën e luftimit, reagimi i tyre në situata kritike dhe përballimi i sulmeve të kundërshtarit nga deti. Për rreth dy orë trupat e angazhuara në stërvitje demonstuan profesionalizëm, disiplinë, aftësi për të ndërvepruar dhe fuqi e shpejtësi për të realizuar me sukses misionin e ngarkuar. Spektri i

plotë i operacionit iu dha mundësinë të gjithë elementeve të demonstrojnë aftësinë e tyre për të përmbushur detyrat e caktuara në funksion të misionit. Trupat tona dhe në këtë demonstrim treguan përkushtim dhe disiplinë të lartë në realizimin e të gjithë elementeve që kërkonte realizimi i detyrës së ngarkuar. Në përfundim të stërvitjes gjeneralmajor Bazo, pasi i falenderoi trupat për profesionalizmin e treguar në fushën e stërvitjes, u shpreh: “Ndjem thellësisht i privilegjuar që më jepet mundësia t’i drejtohem Brigadës së Mekanizuar “Sassari” tashmë shumëkombëshe për shkak të marrjes në “gjirin” e saj edhe të njëjseve e formacioneve nga vende aleate e partnere të Aleancës”. Duke përgëzuar të gjithë personelin pjesëmarrës në stërvitje, ai theksoi se sa e rëndësishme është të stërvitemi së bashku pasi stërvitja është mënyra më e mirë për të mbajtur nivelin e duhur të aftësive operacionale dhe ndërveprueshmërinë si çelës të suksesit. “Kjo stërvitje e madhe shumëkombëshe bëhet në një situatë ku nga të gjithë ne kërkohet një përkushtim i lartë, si dhe një gatishmëri për tu përballur me të gjitha sfidat që mund të ketë NATO. Ne si pjesë e Aleancës duhet të tregojmë së jemi të aftë për të përmbushur gjithë detyrimet që rrjedhin nga antarësimi në NATO, si dhe kërcënimet dhe rreziqet që vijnë si nga shtete ashtu dhe organizata armiqësore me NATO-n”, - ka nënvizuar gjeneralmajor Bazo.

Nënkolonel Ediand Elezi



Policia Ushtarake teston kapacitetet për Emergjencat Civile

Në zbatim të Programit të Veprimtarive Kryesore të Policisë Ushtarake për vitin 2015, nga data 29-30 tetor 2015, Policia Ushtarake zhvilloi stërvitjen “Vlerësimi i kapaciteteve operacionale të Kompanisë së Dytë të koduar “Shëngjergji-15”. Kjo stërvitje 48 orëshe u planëzua dhe u zhvillua për testimin e kapaciteteve operacionale të Policisë Ushtarake në mbështetje të njërive dhe reparteve të Forcave të Armatosura të angazhuara në Emergjencat Civile. Ajo u realizua në tre faza:

Faza e parë konsistoi në përgatitjen e dokumentacionit dhe pajisjeve të nevojshme për stërvitje;

gjatë fazës së dytë u bë testimi i kapaciteteve operacionale të nën-repartit të Policisë Ushtarake; ndërsa faza e tretë dhe përfundimtare ishte zhvillimi i stërvitjes në terren (në kushtet fushore) nga forcat pjesëmarrëse.

Qëllimi i stërvitjes “Shëngjergji-15” ishte aftësimi i strukturës së drejtimit të Kompanisë së Dytë Operacionale, si dhe zhvillimi i kapaciteteve reaguese të saj për mbështetjen e FA-së të angazhuara në Emergjencat Civile, duke ndjekur dhe zbatuar me rigorozitet procedurat standarde të drejtimit të trupave gjatë procesit të planëzimit, ekzekutimit dhe analizës së stërvitjes për testimin e kapaciteteve të PU në Emergjencat Civile.

Objektivat e planifikuar dhe të arritura në përfundim të stërvitjes ishin:

- Rritja e nivelit të linjës komanduese të kompanisë pjesëmarrëse në stërvitje;
- Aftësimi për përdorimin e procedurave standarde të drejtimit dhe testimin e sistemeve të komunikimit e informacionit dhe pajisjeve mbështetëse.



Stërvitja u planëzua dhe u realizua me sukses falë një pune profesional të shtabit të Policisë Ushtarake dhe të komandantit të Kompanisë së Dytë Operacionale në hartimin, planifikimin dhe ekzekutimin e dinamikës stërvitore. Në përfundim të stërvitjes trupat pjesëmarrëse u inspektuan nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA-së, gjeneralmajor Jeronim Bazo, i cili në një brifing të shkurtër u njoh nga afër me punën e bërë dhe rezultatet e arritura në stërvitje.

Me këtë rast, gjeneralmajor Bazo përshëndeti trupat pjesëmarrëse në stërvitje dhe i uroi për rezultatet e arritura në përfundim të saj. Policia Ushtarake me këtë stërvitje, tha ai, ka treguar se di ti paraprijë situatave të ndryshme në Emergjencat Civile, në të cilat vendi ynë është përfshirë vitet e fundit. Ideimi i stërvitjeve të kësaj natyre shërben për dhënien e ndihmës

dhe koordinimin me autoritete civile në EC nëse Forcat e Armatosura do tu kërkohet të përfshihen dhe të japin ndihmësën e tyre. Më tej, në fjalën e tij gjeneralmajor Bazo theksoi se, duke parë ngjarjet e fundit që po ndodhin në rajon dhe fluksin e emigrantëve që përdorin Ballkanin si rrugë kalimi, mendohet që edhe Shqipëria mund të jetë një destinacion i mundshëm kalimi dhe nëse FA do të përfshihen në operacionin e pritjes së tyre, atëherë duhet të jemi gati për të treguar gatishmërinë e duhur për menaxhimin e këtij lloji operacioni, ku ju si Polici Ushtarake do të keni një punë të vështirë dhe përgjegjësi të madhe. Kjo stërvitje dhe skenarët që keni marrë në konsideratë do ju ndihmojnë të përballeni me sukses në operacione të tilla. “Policia Ushtarake ka detyra shumë planëshe, të vështira, por dhe shumë fisnike. Kompletimi me mjete të reja të blinduara për ju rrit në një shkallë më të lartë të kapaciteteve operacionale në kompletimin me pajisje, por kjo kërkon angazhim, përgatitje dhe stërvitje me këto mjete për të lëvizur paralelisht kapaciteti operacional i pajisjes me mjete me atë të përdorimit të tyre dhe stërvitjes. Përgëzime për stërvitjen që zhvilluat dhe ti gëzoni mjetet e reja”, - është shprehur në fund të fjalës së tij shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA-së, gjeneralmajor Jeronim Bazo.

Komandanti i Policisë Ushtarake, kolonel Xhevdet Zeneli falënderoi gjeneralmajor Jeronim Bazon dhe Shtabin e Përgjithshëm të FA për mbështetjen që kanë dhënë për Policinë Ushtarake dhe premtoi që Policia Ushtarake do të jetë gjithmonë e gatshme në përballimin e situatave nga më të vështirat dhe në zbatimin me rigorozitet të detyrave që do të ngarkohen nga Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm i FA-së. Gjithashtu, kolonel Zeneli falënderoi dhe efektivin e Kompanisë së Dytë për seriozitetin dhe disiplinën e treguar gjatë stërvitjes.

Togere Xhesika Xhajku

Bashkëveprim dhe profesionalizëm në stërvitjen “Durrës-SAR-ex-2015”

SHEFQET KËRCELLI

Para pak ditësh, në rajonin e Kepit të Palit u zhvillua stërvitja “Durrës-SAR-ex-2015”. Në këtë stërvitje morën pjesë personel dhe mjete të Forcës Detare, Forcës Ajrore, Antikontrabandës Detare, Policisë Kufitare dhe të emigracionit në Durrës, Qendra Operacionale Ndërinstitucionale Detare dhe Inspektoriatit të Peshkimit. Qëllimi i stërvitjes ishte organizimi i bashkëveprimit, kryerja e operacioneve të përbashkëta midis Flotiljes Detare dhe institucioneve që kanë interesa në det, në kuadër të operacioneve për zbatimin e ligjshmërisë dhe kërkim-shpëtimit SAR, si dhe testimi i mjeteve e procedurave të komunikimit për bashkëveprim në operacion. Stërvitja u ndoq dhe nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo, komandanti i Forcës Detare, general brigade Ylber Dogjani, komandanti i Forcës Ajrore, general brigade Vladimir Avdiaj, ushtarakë të lartë të MM e SHP, kuadro të Forcës Ajrore dhe Flotiljes Detare, shefi i Antikontrabandës Detare Ylli Hatellari, drejtues të Policisë Kufitare në Durrës, komisarët Erjon Ismaili dhe Gentian Xhaferri, përfaqësues të QNOD, grupi i ushtarakëve të seminarit Rajonal për Operacionet e kërkim-shpëtimit SAR (anëtarë të qendrës RACVIAC) etj.

Fillimisht, komandanti i Forcës Detare, gjeneral brigade Ylber Dogjani i uroi mirëseardhjen personaliteteve ushtarake dhe civile që ndoqën këtë stërvitje dhe më pas theksoi rëndësinë e “Stërvitjes Durrës-SAR-ex” 2015, si një masë e rëndësishme e Forcës Detare për këtë vit, që i shërben direkt shtimit të kapaciteteve operacionale të Flotiljes Detare dhe bashkëveprimit efektiv me institucionet detare në vendin tonë. Më pas u zhvillua stërvitja në gjirin e Kepit të Palit bazuar në dy skenarë kryesorë. Drejtues të stërvitjes ishin komandanti i Flotiljes Detare, Kapiten i Rangut të Parë Ferdinand Kreshpani dhe ai Grupit të II Patrullues të kësaj Flotilje, Kapiten i Rangut të III Besnik Cami. Shpjegimi i elementëve të stërvitjes dhe fazave të saj u bë në shqip dhe anglisht nga kapitenët e rangut të tretë Gentian Prifti dhe Bedo



Merruko. Skenari i parë i stërvitjes kishte temë zbatimin e ligjshmërisë, kur një anije tregtare e huaj kryen aktivitet kontrabandë në rajonin Porto-Romano-Kepi i Palit. Kështu Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare (NOD), nëpërmjet oficerit të drejtimit të FD dhe atij të Policisë Kufitare njofton se në orën 10.00 të datës 28 tetor 2015, në rajonin Porto-Romano-Kepi i Palit, ka dyshime se një mjet i shpejtë detar kryen kontrabandë nga deti në breg. Ndërsa anija e madhe “Bela”, imituar nga anija P-131, me komandant kapiten lejtënant Alfred Velaj, qëndron në gjirin e Kepit të Palit dhe ka në bord mjetin e shpejtë. Informacioni plotësohet dhe më të dhënat e kapitenerisë për këtë mjet të huaj detar. Informacioni vlerësohet nga QNOD dhe oficerët e drejtimit të FD dhe Policisë Kufitare urdhërojnë bllokimin e mjetit të shpejtë tip gomone që kryen kontrabandë. Fillimisht vihet në veprim anija e gatëshme P-110 me komandant kapiten lejtënant Daniel Zeneli, me vendbazim në Kepin e Palit, e cila i afrohet me shpejtësi gomones nga drejtimi verior. Ndërkohë, skafi i Policisë Kufitare lëviz nga Porto-Romano dhe të dy mjetet bashkëpunojnë e manovrojnë për të bllokuar mjetin kontrabandues. Në vijim, gomonia tenton të

largohet në det të hapur, por bllokohet nga mjetet tona. Ndërkaq, operacioni vazhdon me bordimin e anijes “Bela” nga djemtë e grupit të bordingut, nënlejtënant Sulaj e Bakallli, n/tetar Lika, detarët Panxho e Balla dhe infermjer Brahaj, me komandant toger Besmir Pepa. Me veprime të shpejta e të sakta, skafi i antikontrabandës P-003 dhe anija P-118 me komandant kapiten lejtënant Alket Cullhaj, i afrohen anijes tregtare nga veriu, ndërsa anija “Archan-gel”, P-04 me komandant kapiten lejtënant Aranit Demcedhe skafi i Policisë Kufitare PB.02, manovrojnë për bordimin e anijes kontrabandiste. Bordingu fillimisht ishte konsensual, por pasi në anije u gjendën armë dhe municione të rrezikëshme dhe shkalla e rrezikut u rrit, djemtë e bordingut vepruan forcërisht. Ndërkohë, anija P-118 bashkë me P-04 bënë sigurimin e grupit tonë të bordingut. Njëkohësisht, me këto veprime në det, një skuadër e truprojes së vendbazimit të Kepit të Palit dhe një skuadër e Policisë së rendit kryen arrestimin e 2 kontrabandistëve në bregun e detit. Gjithashtu, pas kontrollit të anijes “Bela” nga grupi i bordingut u gjetën mallra kontrabandë, armë, municione dhe lëndë eksplozive. Kështu, mbas arrestimit të dy personave jashtë listës së ekuipazhit të anijes, anija “Bela” u shoqërua për në

Mbyllja me sukses të plotë e stërvitjes “Durrës-SAR-ex-2015” shprehu qartë vlerësimin dhe angazhimin e forcave pjesëmarrëse për të kryer me profesionalizëm të lartë çdo elementë dhe skenarë të ngjashëm me situata reale në det

vendbazimin e Kepit të Palit. Kjo shënoi mbylljen e fazës së parë të stërvitjes, ku në saj të veprimeve të shpejta e të sakta të mjeteve të Flotiljes Detare, Antikontrabandës dhe Policisë Kufitare, realizohet bllokimi i shkelsve të ligjit.

Por situata në det përsëri nuk është e qetë, ndaj detarët qëndrojnë në gatishmëri për çdo emergjencë detare. Kështu, në orën 10.30 të po kësaj date, oficeri i drejtimit në QNOD njoftohet nga Kapiten-eria e portit Durrës se ka marrë një sinjal “SOS” nga peshkarexha “DEA”, e cila ka pësuar një avari në motor, ka zjarr në bord, për pasojë rrezikon të mbytet. Në bordin e peshkatores ndodhen pesë persona. Mbasi një komunikimi të mëtejshëm me kapitenin e anijes, u sinjalizua se flakët e zjarrit kishin përfshirë dhe ambientet e brendshme të “DEA”-s dhe jeta e ekuipazhit është në rrezik, ndërkohë 2 peshkatarë për ti shpëtuar flakëve u hodhën në det. S’mjafton me kaq, por pas disa minutash u ndërpre dhe ndërlihdja me peshkatoren. Për zgjidhjen e kësaj situatë emergjente fillimisht iu dha urdher anijeve P-118 dhe P-110, të cilat shkuan menjëherë në vendngjarje dhe ndihmuan në fikjen e zjarrit. Me kërkesën e komandantit të anijes P-118, në ndihmë shkon dhe një helikopter i Forcës Ajrore që merr

një person të lënduar në peshkatore. Por gjatë kontrollit të peshkatores u konstatua se mungonin dhe 2 pjesëtarë të ekuipazhit. Për gjetjen e tyre u përfshinë në operacion SAR, 3 anije të Grupit të II-të Patrullues, helikopteri BO-105, drejtuar nga majorët Koci, Sula, Visha dhe kapitenët Tushe dhe Fero, të cilët ishin dhe kordinatorë në stërvitje, një anije e Policisë Kufitare dhe një e Antikontrabandës Detare. Mbas gjysëm ore kërkimi paralel nga Jugu në Veri të mjeteve detare dhe helikopterit u bë i mundur gjetja e personave në det, të cilëve mbasi iu dha ndihma e parë u çuan në spitalin rajonal të Durrësit. Veprimet e mjeteve në det u koordinuan nga shefi operacional i Flotiljes, Kapiten i Rangut II Qerim Shkrepa.

Stërvitja u konceptua dhe përgatit nga shtabi i Flotiljes bazuar në situatë reale me të cilën institucionet tona detare përballen rregullisht në Detin Jon dhe Adriatik. Radiondërlidhja u sigurua nga Dega e Ndërlidhjes në Forcë e Flotilje, kapiten Dëfrim Cela dhe n/oficer Xhezair Elezi. Në realizimin me sukses të saj punuan gjithë personeli i vendbazimit të Kepit të Palit, të cilët për mëse një muaj u përkushtuan dhe angazhuan secili në detyrën e tij funksionale dhe më tepër. Mbyllja e kësaj stërvitje u shoqërua me duartrokitje nga pjesëmarrësit, gjë që shprehu qartë vlerësimin e veprimeve të forcave pjesëmarrëse gjatë çdo elementi stërvitor dhe skenarëve të ngjashëm me situatë reale në det. Në fund, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Jeronim Bazo, i uroi drejtuesit dhe pjesëmarrësit e kësaj stërvitje për profesionalizmin dhe bashkëveprimin e demonstruar në stërvitjen “Durrës-SAR-ex-2015”, ndërsa gjeneralmajor Zdravko Jakop, zv/drejtor i Qendrës RACVIAC, Kroaci, falenderoi shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FA Shqiptare dhe komandantin e FD-s për mundësinë e krijuar në ndjekjen e kësaj stërvitje detare, që përkon dhe me objektivat e seminarit që u zhvillua këto ditë në Tiranë për operacionet SAR. Mbas përcjelljes së personaliteteve ushtarake dhe civile, komandanti i Forcës Detare, gjeneral brigade Ylber Dogjani takoi në veçanti personelin pjesëmarrës të stërvitjes dhe i uroi atyre suksese të mëtejshme në realizimin e detyrave të përditëshme.

NË KOMANDËN E MBËSHTETJES

Përfundoi Kursi Bazë dhe i Avancuar i
Nënoficerit në specialitetet furnizim

Në ambientet e Qendrës Stërvitore të Komandës Mbështetëse u zhvillua ceremonia e përfundimit të Kursit Bazë dhe i Avancuar i Nënoficerit në specialitetet furnizim. Në këtë ceremoni ishte i pranishëm shefi i Shtabit të Komandës Mbështetëse, kolonel Lulzim Xhafa, komandanti në detyrë i Qendrës Stërvitore nënkolonel Shkurte Bytyçi, si dhe të ftuar të tjerë nga Komanda Mbështetëse.

Fjalën e hapjes e mbajti nënkolonel Shkurte Bytyçi, e cila në cilësinë e drejtuesit të kësaj Qendre shprehu mirënjohje dhe respekt për grupin e kursantëve që ndoqën këtë kurs. Konsolidimi i Trupës së N/oficerit është një domosdoshmëri, ashtu si dhe forcimi i rolit të tyre, si pjesë përbërëse e rëndësishme e Forcave tona të Armatosura. Kursi Bazë dhe i Avancuar i N/oficerit në specialitetin furnizim, i tha ajo kursantëve, ju ka paisur juve me njohuri teorike, praktike, teknike e menaxhuese, si dhe aftësi drejtuese e komanduese sipas nivelit. Këto njohuri të përvetësuara do ju bëjnë të ndjeheni më të aftë dhe më komod në arritjen objektivave në të ardhmen. Nënkolonele Bytyçi vlerësoi gjithashtu përkushtimin, interesimin dhe impenjimin që ata treguan gjatë periudhës stërvitore, mbështetjen e dhënë nga Komanda Mbështetëse, si dhe i uroi kursantëve suksese të mëtejshme në karrierën ushtarake dhe ngritjen e tyre profesionale.

Më pas, fjalën përshëndetëse e mori shefi i Shtabit të Komandës Mbështetëse, kolonel Xhafa, duke iu drejtuar kursantëve pjesëmarrës, theksoi se përfundimi i këtyre kurseve ju mundëson pozicionimin në një detyrë me më shumë përgjegjësi, si dhe ju hap rrugën që nëpërmjet punës tuaj të mund të vijoni të sigurt karierrën ushtarake, më konkretisht për Kursin Bazë për detyra komandant skuadre dhe mundësinë për përparim në gradën e radhës, ndërsa për Kursin e Avancuar për detyra si zv/komandant toge dhe mundësinë e përparimit në gradë. “Unë do t’ju kërkohet që njohuritë e marra në këtë kurs të mund ti aplikoni në funksionet dhe detyrat që do keni në të ardhmen. Të përpiqeni për tu vetzhvilluar gjatë kryerjes së detyrës nëpër reparte, si dhe të kërkonit me punën tuaj ndjekjen e kurseve të tjera për të vijuar dhe patur një karrierë të sukseshme në fushën e logjistikës”, ka theksuar kolonel Xhafa.

Vlen për tu theksuar se Qendra Stërvitore e Komandës Mbështetëse gjatë kësaj periudhe ka trajnuar një personel të posaçëm në Batalionin e Transportit për transportin e lëndëve të rrezikshme. Ky trajnim zgjati një javë. Gjatë këtyre ditëve u trajtuan tema dhe specifika lidhur me mënyrat e transportimit të lëndëve të rrezikshme. Interesi nga ana e personelit ishte në nivelet e duhura dhe rrjedhimisht përvetësimi ishte i kënaqshëm.

Në fund të ceremonisë janë shpërndarë certifikata për disa nga kursantët që përfunduan këto kurse me rezultate të larta.

Karafil Celibashi



Qendra Stërvitore e Komandës Mbështetëse gjatë kësaj periudhe ka trajnuar një personel të posaçëm në Batalionin e Transportit për transportin e lëndëve të rrezikshme. Ky trajnim zgjati një javë. Gjatë këtyre ditëve u trajtuan tema dhe specifika lidhur me mënyrat e transportimit të lëndëve të rrezikshme. Interesi nga ana e personelit ishte në nivelet e duhura dhe rrjedhimisht përvetësimi ishte i kënaqshëm.

Kompania EOD vazhdon pastrimin e
poligoneve të asgjësimit të municioneve

Në zbatim të urdhërit të Ministrit të Mbrojtjes “Për pastrimin e poligoneve të asgjësimit të municioneve”, nga efektivitë i kompanisë EOD vazhdon puna në poligone të ndryshme. Qëllimi i këtij operacioni i shtrirë njëkohësisht në disa poligone të vendit është kufizimi i zonës së poligonit, kontrolli, evidentimi i municioneve të rrezikshme, nxjerrja e municioneve, grumbullimi, transportimi dhe asgjësimi i tyre, si dhe vendosja e mjeteve sinjalizuese që tregojnë se poligonet janë territor i infektuar nga municionet dhe eksplozivët. Në përgjithësi poligonet kanë një shtrirje të madhe sipërfaqësore, si p.sh., poligoni i Voskopojës ka një hapësirë 314 ha dhe me një vatër asgjësimi 2.5 ha, ai i Kepit të Skënderbeut 201 ha dhe kështu më radhë. E gjithë kjo sipërfaqe kërkon kohën, përkushtimin dhe profesionalizmin e duhur për të bërë të mundur siguri absolute për komunitetin e zonave përkatëse. Grupe të specializuara dhe të trajnuara në këtë fushë me përgjegjësi të plotë dhe profesionalizëm të lartë po operojnë në këto poligone, si dhe po informojnë banorët e zonës për të qenë të kujdesshëm në



rast evidentimi të një municioni apo mbetje municioni.

Nga raportimet e bëra nga drejtuesit e grupeve të punës në terren, bëhet e ditur se janë gjetur mbetje municionesh të ndryshme dhe janë asgjësuar sipas procedurës. Gjithashtu, në vazhdim të këtij operacioni, përtej kontrollit sipërfaqësor, janë bërë markime, mbishkrime dhe janë vendosur tabela sinjalizuese/informuese lidhur me

rrezikshmërinë e municioneve dhe rëndësinë e tyre.

Prej vitesh këto poligone kanë qënë funksionale dhe nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së. Ky fakt i ka njohur banorët e zonave me rrezikshmërinë e lartë që kanë municionet, mënyrën si duhet vepruar në rast të evidentimit me to dhe raportimi në strukturat policore



të zonës. Vlen për tu theksuar bashkëpunimi që banorët e zonave përreth poligoneve kanë treguar ndër vite në lidhje me evidentimin dhe raportimin e municioneve të gjendura rastësisht nëpër poligone, të cilat shpesh dalin në sipërfaqe për shkak të ndryshimeve atmosferike, si rreshjet e shiut dhe bimësia rreth e përqark.

Operacioni vazhdon.

Rreshter Bledar Blaceri

Rreth çështjes së luftës




NËNKOLONEL MARIONA LILO,
STUDENTE NË KLO

Përpjekjet për të ofruar një kuptim të marrëdhënieve ndërmjet fitimit të luftës dhe krijimit të shtetit në botë janë ndërmarrë nga shumë studiues të Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Studimeve Strategjike. Në shumicën e këtyre përpjekjeve vëmendja është përqëndruar në atë se si shteti i formuar në Evropë ndryshonte nga pjesët e tjera të botës. Në këtë kontekst, ka ardhur dhe një numër botimesh mbi kolapsin apo përkeqësimin e shteteve në Afrikë. Lidhur me këtë është dhe çështja e luftës dhe se si bota është munduar për ta kuptuar atë. Në të gjitha këto përpjekje autorë të ndryshëm janë përpjekur të shpjegojnë ndryshimet që kanë ndodhur në lidhje me natyrën e luftërave dhe konflikteve në botë.

Libri “Shteti, lufta dhe gjendja e luftës” të autorit Kalevi J. Holsti, megjithëse në një mënyrë shumë të detajuar dhe të përshtatshme, përpiket për të reflektuar se çdo kuptim marrëdhënies ndërmjet luftës dhe shtetit është një konstrukt historik. Libri sjell premisën se natyra dhe sjellja e luftës para vitit 1945 dallon nga natyra dhe zhvillimin e luftës pas vitit 1945. Ky pozicion buron nga pikëpamja se luftërat deri në vitin 1945 janë zhvilluar mes shteteve (ndërshtetërore). Gjatë kësaj kohe, autori pohon se luftërat kanë ndjekur një rend kronologjik, i cili zakonisht fillon me shpalljen e një ultimatumit. Epoka pas vitit 1945, ndeshi më shumë luftëra që burojnë nga brenda shteteve (brenda-shtetërore), të cilat autori i quan si luftërat e llojit të tretë. Autori argumenton se në vitin 1970 janë rregjistruar 921.000 vdekje përmes luftimit, por prej këtyre gati 90% (820.000) ishin për shkak të luftërave civile. Gjatë gjithë këtij seksioni është bërë një përpjekje për të kuptuar pse shtetet shpallin luftë kundër njëri-tjetrit dhe pse grupet e ndryshme brenda një shteti ngrihen kundër njëri-tjetrit ose kundër vetë shtetit.

Pjesa tjetër e librit merret me çështjen e bërjes së shtetit apo krijimit të shtetit. Shkrimtari nëpërmjet paraqitjes së ngjarjeve historike të çon në krijimin e shteteve moderne evropiane dhe paraqet se kjo është e qartë se si këto procese ndryshojnë rrënjësisht nga mënyra në të cilën janë krijuar shtetet në kontinente të tjera. Për shembull, autori pohon se krijimi i shtetit në Evropë ishte e lidhur me luftën dhe ishte një proces i gjatë, ndërsa në pjesë të tjera të botës një proces i tillë ishte i penguar për të ndodhur për shkak të kolonializmit.

Në thelb, libri argumenton se për të



kuptuar të këqiat e ditëve të sotme që lidhen me shtetet e ish-kolonive, si ato të Afrikës, e ka shprehur në mënyrën të qartë se në këtë pjesë të botës në të cilën kolonializmi sistematikisht tregon se krijimi i shtetit do të jetë problematik. Sjellja kolonialistë gjatë kësaj epoke, tregon se ata kurrë nuk menduan se, dikur, një shtet një ditë do të formohet nga njerëzit indigjenë. Në këtë kontekst, libri tregon se si post-pavarësisë “shtetet” kanë përjetuar një numër të problemeve brenda vetes dhe se si ata u përballën me armiq të brendshëm, në vend të “armiëve” të jashtëm. Kjo është një nga arsytet pse anarkia brenda shteteve sesa midis shteteve ka qenë burim i luftës dhe konfliktit në periudhën e pas vitit 1945. Diskutimi është pasuar më pas me një vështrim në çështjen e të fortit kundrejt shteteve të dobëta; faktorët që çojnë në të qenit një shtet i dobët dhe të tjera të qenit të forta, si dhe mënyrat e përcaktimit të ndryshimit. Sipas autorit, një shtet i fortë karakterizohet ndër të tjera, nga kapaciteti për të komanduar dhe të drejtën për të sunduar dhe për të ruajtur një monopol mbi përdorimin legjitim të forcës. Në të kundërtën, një shtet i dobët nuk ka respekt për autoritetin qendror në mesin e komunitetit. Ajo karakterizohet edhe nga politika e personalitetit ku institucioni bëhet sinonim idetyrës. Njeriu nuk duhet të shikojmë shumë larg.

Ka shtete në Afrikë që lehtë mund të karakterizohen si të dobët. Gjëja e rëndësishme që duhet të theksohet është se ky seksion ngre një sërë pyetjesh rreth mendimit të krijimit të shtetit të bazuar në konceptet peren-

dimore. Pyetja është nëse ekziston një alternativë për një koncept të tillë, duke pasur parasysh faktin se shumica e shoqërive jashtë Perëndimit kishin sisteme të ndryshme politike.

Pjesa e fundit e librit merret me rolin e organizatave ndërkombëtare, veçanërisht të OKB-së, në zgjidhjen e konflikteve dhe trajtimin e problemeve të lidhura me shtetet e dobëta dhe të dështuara. Autori pohon se Karta e OKB-së është themeluar në një sistem Eestphalian, i cili miraton parimet e sovranitetit dhe integritetit territorial. Një nga sfidat me të cilat përballlet OKB sot është se në qoftë se ajo duhet të niset pas veprimeve të duhura humanitare, dhe nëse ajo është në gjendje që të marrë përgjegjësinë në parandalimin e masakrave të civilëve. A do të duhet ajo të shkeli parimin e sovranitetit dhe kështu ridefinojnë rolin e saj në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Libri i Holstit është me interes, sepse lexuesit perfitojnë një vështrim të ri për natyrën bashkëkohore të marrëdhënieve shtetërore dhe ndërkombëtare. Ai ngre jo vetëm pyetje të rëndësishme, por gjithashtu vë teorinë e marrëdhënieve ndërkombëtare në testim mbështetur nga ngjarjet historike dhe përvojat e vendeve perëndimore, ose në dominimin e “Fuqive të Mëdha”, në kurriz të shteteve më të vogla. Prandaj, libri sfidon pikëpamjet e ashpra midis lidhjeve të luftës dhe konfliktit, si dhe paqes dhe stabilitetit në botë. Libri gjithashtu shërben si një burim i shkëlqyer reference, sepse ai mbart me vete një shtojcë të plotë nga rajoni dhe bota të konflikteve të mëdha të armato-

Rubrika: Flasin studentët e Kursit të Lartë të Oficerit në AFA

Studentët pjesëmarrës në KLO kanë nisur realizimin e detyrave individuale, sipas temave të lëndës “Teori të luftës dhe strategjisë”, nën drejtimin e pedagogut Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj. Me këtë rast, gazeta “Ushtria” çel rubrikën “Flasin studentët e Kursit të Lartë të Oficerit në AFA” nëpërmjet së cilës do të pasqyrojë herë pas here esse, recensa dhe opinione të përzgjedhura nga studentët pjesëmarrës në këtë Kurs, të cilat gjykojmë se vlejnë të njihen dhe studiohen edhe nga ushtarakë të tjerë të niveleve të ndryshme të Forcave tona të Armatosura.

sura nga viti 1945 deri në 1995.

“Shteti, lufta, dhe gjendja e luftës” është një diskutim inteligjent dhe provokues i problemit më serioz ndërkombëtar të kohës sonë. Argumentet plotësohen me shembuj përkatës të vërtetë të botës. Libri paraqet një urë të bukur mes realizmit të vjetër dhe rrymave të reja të menduarit rreth luftës dhe paqes. “... Ky është një expostion jashtëzakonisht koherent dhe i shkruar mirë i një problemi të madh aktual në çështjet botërore, në konfliktet e armatosura që nga viti 1945 dhe një bibliografi shteruese”, - ka theksuar Paul Rich. Libri shqyrton burimet e hidhura të konflikteve të zgjatura që rezultojnë në tragjeditë e pafundme të vdekjeve njerëzore dhe flukset në masë të refugjatëve. Duke argumentuar se konflikte të tilla janë të destinuara të jenë luftërat e së ardhmes, ai zhvillon ide për zgjidhjen e konflikteve dhe paqen që rrjedhin prej tyre.

Lufta ka qenë tradicionalisht e studiuar si një problem që rrjedh nga marrëdhëniet midis shteteve. Doktrinat strategjike, marrëveshjet për kontrollin e armëve dhe themeli i organizatave ndërkombëtare si Kombet e Bashkuara janë të dizanuara për të parandaluar luftërat midis shteteve. Që nga viti 1945, megjithatë, tendenca e luftës ndërshtetërore është në fakt në rënie të shpejtë, ndërsa tendenca e luftërave të brendshme është rritur. Autori argumenton se, në mënyrë që të kuptojnë këtë ndryshim të rëndësishëm në modelet historike, ne duhet të shkëputemi prej elementëve analitike që rrjedhin nga studimet e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe të zhvendosim vëmendjen në problemet e shteteve të ‘dobëta’, ato shtete që nuk kanë mundësi për të mbështetur legjitimitetin e brendshëm dhe paqen. Pse kemi Ruanda, Bosnie apo Somali? Ky libër eksploron burimet e hidhura, konflikte të tilla të zgjatura që rezultojnë në tragjeditë e pafundme në njerëz të vdekur dhe flukset e refugjatëve në masë. Autori argumenton se konfliktet e tilla, dhe jo luftëra midis shteteve, janë luftërat e së ardhmes. Çfarë mund të bëjnë Kombet e Bashkuara dhe institucionet e tjera ndërkombëtare rreth tyre?

Munden organizatat e projektuara për të menaxhuar konfliktet mes shteteve të menaxhojnë me sukses luftërat, origjinat e të cilat janë të brendshme? Autori zhvillon disa ide për zgjidhjen e konflikteve dhe paqes që rrjedhin nga përvoja të tilla. Ai i jep një studim të thelluar historik luftës së njerëzimit, pastaj përqendrohet në atë që ai i njehson si “luftërat e llojit të tretë” ose konflikti me intensitet të ulët. Ai dokumenton raste studimore të luftërave të llojit të tretë, pastaj përqendrohet në atë që mund të bëhet për të zgjidhur këtë lloj të ri të konfliktit.

Holsti me të drejtë thekson se, ndërsa luftërat ndërshtetërore kanë qenë në rënie, numri i luftërave të brendshme është rritur. Ai beson se një arsye e madhe për këtë është problemi në rritje i shteteve të dobëta. Që nga viti 1945 kriteret për të qenë një shtet sovran janë ngatërruar ose është i errët dhe shumë prej tyre që kanë lindur u mungon fuqia për të mbajtur një identitet. Identiteti mund të duket një zgjidhje, por në përgjithësi ekonomitë e shteteve fqinje nuk mund të durojnë riatdhesim masiv të duhur. Zgjidhja tjetër e dukshme është, natyrisht, ndarje. Politika amerikane në këto situata, për shembull, në përgjithësi është mospërfillës i ndarjes duke ofruar pak alternativa. Demokratizimi dhe federalizmi janë vënë përpara si zgjidhje për rritjen befasuese në numrin e konflikteve të brendshme, por Holsti beson se zgjidhja në fund të fundit - në qoftë se me të vërtetë nuk është një - është se shtetet e dobëta thjesht duhet të bëhen më të fortë apo të hartohen disa alternativa të shtetit. Ai shqyrton në këtë rastin e fundit, në një gjatësi, rolin e mundshëm të Kombeve të Bashkuara, ku qëndrimi është ende “Westphalian” (për të marrë hua nga Candid Voltaire) dhe të preokupuar me sovranitetin dhe integritetin territorial. Ai gjithashtu konsideron se demokraci e stilit perëndimor nuk mund të jetë praktike në disa nga situatat. Për fat të keq, nuk ka përgjigje të gatshme dhe ai sinjerisht konkludon se “problemi i shteteve të dobëta dhe të luftërave të gjata dhe brutale, kjo e keqe, do të jetë me ne për një kohë”.

NËKOLONEL BARDHA PALI
Strategic Advise
in CAG HQ RS-Kabul


Perspektiva gjinore në Forcat e Sigursë dhe Mbrojtjes Kombëtare Afgane

Afganistani njihet si një ndër vendet ku sfida e të qenit grua arrin pothuajse rëndom në kufijtë e tragjikes. Pas rënies së regjimit të talibanëve në 2001 është punuar që gratë të fitojnë disa të drejta, gjë që së pari ka gjetur shprehje në kushtetutën e vendit ku përcaktohet qartë se “shtetasit e Afganistanit, qoftë burrë apo grua, kanë detyra dhe të drejta të barabarta përpara ligjit”. Në kuadër të këtyre ndryshimeve dhe në mbështetje të Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurisë, ku bëhej thirrje palëve në konfliktin e armatosur “që të marrin masa të veçanta për të mbrojtur gratë dhe vajzat nga dhuna me bazë gjinore, veçanërisht përdhunimi dhe format e tjera të abuzimit seksual dhe të gjitha format e tjera të dhunës në situatat e konfliktit të armatosur”, qëllimi kryesor i qeverisë afgane së bashku me disa institucione si Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes është ndërgjegjësimi për rolin e integritimit gjinor në institucionet e sigurisë afgane, si dhe forcat afgane të Sigurisë Kombëtare. Plani është bazuar në njohjen me ngjarjet aktuale dhe dinamikat kulturore që ndikojnë në integrimin gjinor, në veçanti në institucionet e sigurisë, çka nënkupton integrim të femrave afgane në ushtri e polici. Nëse i referohemi periudhës jo të largët të viteve 1996-2001, kur gratë afgane ishin të dënuara me vdekje nëse dilnin jashtë shtëpisë të pashoqëruara dhe të mbuluara tërësisht, kjo mund të duket utopi.

Prandaj është e natyrshme që të lind pyetja: A kanë institucionet e sigurisë afgane plane konkrete në lidhje me perspektivën gjinore? Kjo pyetje çon natyrshëm në një tjetër pyetje që e ka akoma më të vështirë të marrë përgjigje: nëse këto plane janë tashmë të materializuara si dokumente strategjike, si dhe në cilën masë janë zbatuar?

Dokumentet e miratuara dhe rekrutimi i femrave nga Ministria e Brendshme dhe Ministria e Mbrojtjes

Në Ministrinë e Brendshme direktiva e parë për rekrutimin e femrave (rreth 5000 vende pune) është dhënë në vitin 2009, që nënkuptonte se ky numër i përcaktuar do të mund të realizohej deri në vitin 2014. Kurse Ministria e Mbrojtjes, përmes urdhërit të lëshuar në vitin 2010, lidhej me trajnimin e femrave me fondet e Forcave të Sigurisë së Mbrojtjes së shtetit afgan. Edhe këtu mendohej të rekrutoheshin rreth 5000 femra dhe numri i përgjithshëm në të dy institucionet në vitin 2015 të ishte rreth 10000. E thënë me përqindje, objektivi ka qenë që 10% e personelit të këtyre institucioneve të ishin femra. Por në 10 vjet ky objektiv rezultoi në paarritshëm, pasi edhe nga vetë femrat afgane ka mungesë vullneti për t'u integruar në ushtri. Nga ana tjetër edhe nga ana e drejtuesve të Ministrisë së Mbrojtjes Afgane është treguar mungesë dëshire bashkëpunimi në këtë proces. Sot numri i femrave në Forcat



e Armatosura afgane është 868, ose e shprehur me përqindje 0.52%. Pak më mirë paraqitet ky raport në policinë afgane ku numri i femrave është 2448 ose 1.55%.

Roli i Komandës Resolute Support në integrimin e femrave në forcat e Sigurisë Afgane

Qeveria Islamike e Republikës së Afganistanit në koordinim dhe bashkëpunim me Komandën e Resolute Support ka punuar dhe vazhdon të punojë fort për të pasur progres në zbatimin e ligjit dhe transparencës për liritë dhe të drejtat e femrave për t'u integruar në shoqëri. Gjithashtu vëmendja është përqëndruar në heqjen e pengesave për gratë, në mënyrë që ato të shërbejnë në Forcat e Sigurisë Afgane të Mbrojtjes Kombëtare. Komanda e Resolute Support synon të rrisë bashkëpunimin dhe koordinimin me organizatat e ndryshme ndërkombëtare, ambasadat dhe me organizatat e pavaruara ndërkombëtare për integrimin dhe progresin e femres. Integrimi gjinor në Forcat e Sigurisë Kombëtare Afgane është një problem kyç dhe kërkon funksionimin e disa hallkave të cilat jo vetëm duhet të dihen nga liderët kryesorë, por dhe duhet t'i zbatojnë ato. Në mbështetje të Resolute Support, nga zyra për mbështetjen gjinore dhe nga zyrat e tjera si personeli, operacionet etj, është dhënë ndihmesa për funksionimin e institucioneve në përgjithësi dhe të integritimit gjinor në vençati. Këto funksione janë:

Funksioni Bazë 1: Programim, planifikim, buxhetim dhe ekzekutimi;
Funksioni Bazë 2: Trajnim, asistim dhe operacionalitet;
Funksioni Bazë 3: Kodi i sjelles, disiplinës dhe procedura;
Funksioni Bazë 4: Rekrutimi, trajtimi i njejtë si burrat dhe gratë (Force Gender);
Funksioni 5: Uniformat, pajisjet, transporti (Force Sustainment, mbështetja e Forcës);
Funksioni Bazë 6: Strategjitë, politikat, kapacitetet e femrave në opera-

KABUL

Shpreh bindjen se kjo detyrë, pavarësisht vështirësive, është një ndër detyrat për të cilat do t'i jem mirënjohëse stafit drejtues të Ministrisë së Mbrojtjes së vendit tim që më përzgjedhi, por edhe tw Komandës së Resolute Support që më ka mbështetur në të gjitha aktivitetet e mia gjatë këtyre kohëve të qëndrimit në Kabul.

cione (C2 OPS);
Funksioni Baze 7: Kapacitetet e Inteligjencës së femrave (Intel);
Funksioni Bazë 8: Reklamimi dhe fushata e rekrutimit për femrat.

Roli i femrës afgane në shërbimin e Inteligjencës

Femrat afgane po luajnë një rol shumë të rëndësishëm në shërbimin e Inteligjencës, pasi ato më së pari mund të marrin e japin informacion për femrat e tjera në përgjithësi. Me ndihmën e bashkëpunimit civilo-ushtark

mundësohet dhënia e informacionit, po gjithmonë duke respektuar dëshirën e tyre që të sjellin informacion e femrave afgane. Në këtë drejtim ka mungesë të kapaciteve afgane për të trajnuar gratë. Po si mund të mundësohet ky informacion i grave afgane? Ja disa nga rrugët e mundshme:

Së pari, gratë afgane që janë në burg të dënuara, kanë nevojë për gratë në polici që të ndjehen më të sigurta, si dhe më të lirshme të shprehin atë që në vetvete kanë dëshirë ta shprehin, por mundësia më e mirë për t'u shprehur lirshëm për gratë afgane është prania e policëve femra. Por a është e lehtë për këto gra të marrin këto role? A paragjykohej ata nga burrat afgan, nga shokët, miqtë nëse kërkojnë të punësohen në ushtri e polici? Po jeta e familjarëve të tyre a është e sigurt nëse ato zgjedhin të ushtrojnë këto profesione? Bisedat e zhvilluara nga përfaqësuesi e RS zbulojnë se shkalla e paragjykitimit është shumë e madhe. Format e përdorura për ndëshkim ndaj tyre dhe familjeve të tyre janë nga më të rëndomta deri tek më tragjike. Presioni dhe diskriminimi përfshin edhe burrat. Jo rrallë herë dëgjohen dhe e shpeshtë është në biseda stigma se: “burrat që kanë dërguar të punojnë gratë në ushtri me burra nuk janë burra”, ose “nuk janë të zotët të mbajnë gruan në shtëpi”. Por kjo nuk mbaron këtu për fat të keq, pasi ndëshkimi fizik ndaj burrave dhe grave që punojnë në ushtri dhe polici është një formë e përhapur e dhunës, vetëm për shkak të detyrës. Ndëshkimi i këtyre burrave dhe grave që punojnë në polici janë nga më ekstremet, duke i vrrarë e duke i torturuar. Raste të vrasjeve dhe dhunimeve të grave vetëm dhe vetëm



për shkak të detyrës janë të shumtë, ato kanë ndodhur dhe fatkeqësisht po vazhdojnë të ndodhin. Po mjaftoj të jap një prej tyre. Në gazetën “Khaama Press”-Kabul, të datës 15 gusht 2015 u botua lajmi se: “talibanët vranë një grua së bashku me të shoqin në prani të fëmijëve me thikë në provincën e Badakhshan. Arsyeja ishte pasi gruaja punonte në komandën e Policisë në distriktin e Shuhada. Vrasja e të shoqit nga ana tjetër pati si motiv faktin se ishte i pazoti dhe i pafe që të mbante gruan në shtëpi, sipas prononcimit të talibanëve”.

Gjendja aktuale në Afganistan

Afganistani çdo ditë po përballet me shpërthime me ekspolziv, me përleshje mes talibaneve dhe ISIS, me përleshje mes talibanëve dhe forcat e mbrotjes kombëtare, ku çdo ditë ka të vdekur dhe të plagosur. Në të gjithë shpërthimet që bëhen me eksploziv në Afganistan nga talibanët viktimat në të shumtën e rasteve janë gra dhe fëmijë. Ministria e Brendshme sapo ka publikuar një plan të ri zbatimi për gratë në polici, ku aty thuhet se do të rrisin numrin e grave të punësura në polici. Këshilli i policies, këshilltarët e Resolute Support theksojnë se gratë janë shumë të rëndësishme dhe të nevojshme në një forcë policie profesionale dhe profesioniste. Gratë duhet të përfshihen në proceset standarde të PPBE. Për t’u realizuar kjo do punë, do përkushtim dhe vullnet të përbashkët si nga femrat, po ashtu edhe nga drejtuesit e institucioneve dhe nga mbarë personeli. Në lidhje me realizimin e kësaj dua të shpreh disa opinione të lindura gjatë kohës së punës pranë misionit të RS si gender adviser.

Mbi të gjitha është e nevojshme të vendoset një ekuilibër i ndërgjegjshëm mes ndarjes gjinore dhe integritit gjinor. Duke pasur parasysh praktikën në Afganistan ku është dukshëm ndarja femra–meshkuj, përzierja e klasave do të ishte pozitive. Përdorimi i palestrës dhe objekteve të tjera të përbashkëta për meshkuj e femra do të ishte hapi i parë, apo një shans drejt integritit. Kjo sepse steriotipet e roleve gjinore në forcat afgane të sigurisë, luftojnë me të gjitha mënyrat që të pengojnë zhvillimin e forcave profesionale të sigurise tek të dy gjinitë, si tek burrat ashtu edhe tek gratë. Në lidhje me kushtet aktuale të femrave në Forcat e Sigurise afgane të Mbrotjes Kombetare dhe në forcat e policisë, ekziston një nevojë e qartë për më shumë kushte për femrat, për më shume tualete, banjo, dhoma ndenje, kopshte parashkollor që ju adresohen nevojave specifike të grave që i bën ato një pjesë të plotë të barabarte të forcës dhe me të drejta të barabarta. Policia afgane ka gjithsej 226 femra oficerë, 806 nënoficerë dhe 806 shërbim patrulle policie në rrugë. Ushtria afgane ka në Forcat Ajrore: 21 oficerë, 13 nënoficerë, 8 ushtarë dhe 9 studente oficerë që vazhdojnë shkollën, gjithsejt 51 femra. Ushtria Afgane Kombëtare ka: 268 femra oficerë, nënoficerë 293, ushtarë 63 dhe studentë në shkollë për oficerë 152, gjithsej 725. Lidershipi i policisë afgane, ministri i Brendshem, ka shprehur me forcë promovimin e femrave në polici në nivele të larta në pozicionet e marrjes së vendimeve. Gjeneral brigade Jamila Bayaz ka emëruar në pozicionin e shefit të policisë për herë të parë një



femër në janar të 2015. Kjo do të thotë se pozicioni, vlerat dhe përgjegjësia e gruas në poste të ndryshme në polici, duke përfshirë edhe pozicione drejtuese po merr një drejtim të mirë dhe po vlerësohet nga krerët kyesor të policisë dhe nga Ministria e Brendshme.

Kurset për gratë afgane në polici

Në fundit të vitit 2014, policia e Korpusit të grave ka hapur kursin e parë për instruktore femra, pasi ata, së bashku me homologët e tyre, kanë parë nevojën e dëshirën e madhe të femrave afgane që të kenë instruktore femra afgane të policisë kombëtare. Cikli i parë i zhvillimit dhe përfundimit të kursit të instruktorit për femra ishte një sukses i madh dhe lidhej drejpësdrejti me përfshirjen e grave afgane në Policinë Kombëtare. Gjeneral brigade Bashir, komandant i Qendrës së Trajnimit dhe stafi i tij për trajnimin e grave janë duke zhvilluar një tjetër kurs për mësuesi, që po zhvillohet nga Komanda Qendrore e Trajnimit të Komandës së Përgjthshme. Kështu që detyrë gjatë kësaj kohe, edhe për stafin e RS, ka qenë hartimi i programeve sa më të vlefshme për trajnimin e femrave në mënyrë që ato ta përfundojnë me sukses trajnimin e tyre.Suksesi i këtyre instruktorëve të reja femra do të lejojë që ata do të përdoren në Korpusin e trajnimit për programin e oficerit, ku çështjet e grave do të jenë në objektivat kryesore për të ardhmen e afërt te tyre ne Afganistan.

Një tjetër projekt shumë i rëndësishëm është ai i punësimit të grave në shkollat e mesme, universitete dhe komunitet në të gjithë Afgani-stanin. Pasi arsimimi shihet si një çelës kyç për arritjet e objektivave të trajnimit. Jo në pak raste në trajnime të ndryshme femrat afgane kanë arritur rezultate edhe më të mira se meshkujt. Për këtë është ofruar literaturë pasi mungesa e saj në shumicën e rasteve ka penguar trajnimin e rekrutëve të rinj femra në policinë shtetërore afgane. Baza e arsimimit të rekrutëve të rinj në policinë dhe ushtrinë afgane

janë kurset e trajnimit në qendrat e trajnimit fillestar të policisë, ku janë të gërshetuar trajnimi teorik me trajnimin praktik. Leximi ngelet baza e këtij trajnimi. Të gjitha nivelet e policisë shtetërore afgane janë në marrëdhënie me njëri-tjetrin për realizimin e detyrave për mbrojtjen e institucioneve shtetërore dhe për paqen në mbarë vendin. Por ajo që është tepër e rëndësishme lidhet me faktin, se gratë nuk janë lënë jashtë dore në këtë proces. Vlerësimit dhe rekrutimit të grave një vëmendje të veçantë i kanë kushtuar liderët kryesor për Çështjen e Grave, duke e koordinuar këtë me angazhimin e femrave në mbarë vendin. Nga ana tjetër drejtoria e Qendrës së Gruas

”
Një tjetër projekt shumë i rëndësishëm është ai i punësimit të grave në shkollat e mesme, universitete dhe komunitet në të gjithë Afganistanin. Pasi arsimimi shihet si një çelës kyç për arritjet e objektivave të trajnimit. Jo në pak raste në trajnime të ndryshme femrat afgane kanë arritur rezultate edhe më të mira se meshkujt.

në Komandën e Resolute Support po punon për të krijuar një skicë kursesh e trajnimi duke i gërshetuar me përfshirjen e të gjithëve në kurs sipas një programi e grafiku të caktuar. Për atë grup grash që kanë përfunduar trajnimet pranë policisë afgane është planifikuar që ato të vizitojnë disa institucione me qëllim informimin e grave të tjera që ato të shërbejnë si përcjellëse të rolit

dhe prespektivës së grave në policinë dhe ushtrinë afgane. Nëse i hedhim një sy profesioneve që ushtrojnë këto gra të trajnuara për t’u pëfshirë në policinë dhe ushtrinë afgane shohim se ato janë punësuar në logjistikë, financë, personel, infermieri, rrobaqepësi, floktore etj.

Implementimi i Rezolutave 1325 dhe 1612 dhe sfidat që pengojnë rekrutimin e grave

Në qershor të vitit 2015, qeveria e Afganistanit lëshoi planin e saj kombëtar të veprimit për Resolutën e Kombeve te Bashkuara 1325 për Paqen dhe Sigurinë e Grave. Ky plan kishte katër shtylla kryesore veprimi në lidhje me paqen dhe sigurinë e grave: pjesëmarrja, mbrojtja, parandalimi dhe lehtësim/rigjenerimi. Misioni Resolute Support është fokusuar në dhënien e rezultateve në këto zona brenda institucioneve të sigurisë afgane dhe për të siguruar një perspektivë gjinore ai është e përfshirë në të gjitha aspektet e planifikimit në Forcat e Sigurisë dhe Mbrojtjes Kombëtare Afgane, si dhe në misionet, operacionet dhe aktivitetet e saj. Tre janë veprimet strategjike historike të programit të aplikuara për gratë në Forcate Sigurisë dhe Mbrojtjes Kombëtare Afgane:

- Zbatimi i strategjive dhe planeve të miratuara për të rritur dhe për të përmirësuar integritimin gjinor.
- Ofrimi i trajnimeve dhe sigurimi i kushteve në kazermat, si dhe lehtësira të përshtatshme në mjediset e punës për gratë.
- Marrja e masave për të reduktuar dhunën me bazë gjinore dhe ngacmimin seksual ndaj grave.

Por pavarësisht gjithë çfarë kemi përmendur më lart, progresi në Ushtrinë Kombëtare Afgane ka qenë shumë i ngadalshëm. Ka një mungesë të theksuar të grave në nivele të larta në të gjithë institucionet e sigurisë afgane. Që nga korriku i vitit 2015, numri i femrave në Forcat e Sigursë dhe Mbrojtjes Kombëtare Afgane kap shifrën 3478 (Polici, Ushti dhe në Forcat Ajrore), nga të cilat 816 janë oficerë, 1258 nënoficerë, 1150 ushtarë

dhe 521 studente. Padyshim mungesa e kushteve ndikon në ngadalësimin e procesit të rekrutimit të femrave. Po kështu edhe mungesa e zonave rekreative apo objekteve të trajnimit. Kjo do të vazhdojë të jetë një sfidë e madhe gjatë disa viteve të ardhshme, derisa disa projekte të gjejnë zbatim dhe të ndikojnë në përmirësimin e kushteve për gratë. Jo në pak raste ndihet edhe mungesa e angazhimit të lidershipit të Ushtrisë Kombëtare Afgane për zhvillimin e programeve të synuara apo stimujt për gratë që iu bashkohen atyre. Komanda e Resolute Support është duke punuar që të sigurojë më shumë këshilla trajnimi dhe ta çojë numrin e pozicioneve të ofruara nga Tashkili për gratë në 5000 për çdo vit, deri më 2020. Abuzimi seksual, ngacmimi dhe dhuna me bazë gjinore ngelen një kërcënim i prekshëm për integritimin e sukseshëm të grave dhe mbajtjen e tyre afatgjatë në Forcat e Sigurisë dhe Mbrojtjes Kombëtare Afgane. Strategjia e punë së zyrës gjinore në Komandën Resolute Support mbështetet nga një rrjet i këshilltarit gjinor rajonal. Ajo krijon mundësi që gratë në uniformë të takohen me njëra-tjetrën, të diskutojnë dhe të ndikojnë në çështjet që janë në diskutim.

Promovimi

Përkrahja, mbështetja, garantimi i vendit të punës për femrat, gradimi, ngritja në pozitë dhe në pozicione drejtuese duhet zhvilluar mbi një plan rekrutimi për AAF që përfshin femrat. Pikërisht këto probleme i trajtuan dy konferencat e gruas të zhvilluara në 10 gusht dhe 31 tetor me një pjesëmarrje në nivelet më të larta, që mund të jenë objekt i një shkrimi tjetër. Si përfaqësuese e drejtorisë Command Action Group, të Misionit RS, e ftuar për të ndjekur këto konferenca mund të them se sapo ka filluar përballja me stigmen e grave police apo pjesë e forcave të mbrojtjes. Kryerja e kësaj detyre është një përgjegjësi e madhe morale, pasi së pari jam një ushtarake në mison, por mbi të gjitha jam një grua, që e kupton vështirësinë e madhe që ndeshin gratë në Aganistan kur provojnë të janpin kontributin e tyre në detyra të të tilla të vështira si policia e ushtria. Pra, një vështirësi që është çdo ditë në luftë të vazhdueshme jo vetëm me luftën fizike, por edhe me luftën që zhvillohet brenda tyre: të pëballen me mentalitetin, që shpesh ju kushton edhe jetën dhe të sjellin ndryshimin, apo të tërhiqen në heshtje me frikën e humbjes. Një dilemë që një pjesë e vogël, por e mjaftueshme e këtyre grave e ka zgjidhur duke arritur të bëhen një shembull frymëzues. Integrimi dhe prespektiva gjinore ka qenë i vështirë kudo, edhe në vendet e përparuara, po ai kurrë nuk është i pamundur. Ndaj shpreh bindjen se kjo detyrë, pavarësisht vështirësive, është një ndër detyrat për të cilat do t’i jem mirënjohëse stafit drejtues të Ministrisë Mbrojtjes së vëndit tim që më përzgjodhi, por edhe komandës së RS që më ka mbështetur në të gjitha aktivitetet e mia gjatë këtyre kohëve të qëndrimit në Kabul.

Kushtrim Zaçe në rrëfimin e singertë të Marjeta Zaçe (Pronjari)

ALBERT Z. ZHOLI

Kushtrim Zaçe është një nga legjendat e basketbollit shqiptarë. Lojtarë titullarë për më se 12 vjet i ekipit të “Partizanit” dhe atij Kombëtarë. Me një karrierë të shkëlqyer sportive. Me “Partizanin” 12 herë fitues i titullit kampion; 10 herë fitues i Kupës së Republikës dhe 2 herë fitues i Spartakiadës Kombëtare dhe 3 herë kampion me ekipin e të rinjve “Lokomotiva”. Për më se 5 vjet rresht ka qenë instruktor i Edukimit Fizik në Shkollën e Instruksionit në Zall-Herr. Më pas mësues në “Shkolla e Kuqe”, trajner i ekipit “Studenti”, shef i përgatitjes fizike në forcat RENE, drejtor i Pallatit të Sportit “Asllan Rusi” etj. I dekoruar me Urdhërin “Naim Frashëri”, Mjeshtër i Merituar i Sportit, Nderi i Sportit Shqiptar, Qytetar Nderi i Tepelenës, medalja “Për shërbime të shquara” nga Ministria e Mbrojtjes, Mjeshtër i Madh i Sportit, pas vdekjes.


Kur përkojnë fillimet e Kushtrimit në sport?

Në basketboll fillimet e Kushtrimit përkojnë në qytetin e origjinës, në Tepelenë, në vitet 1964-1966, kur Tepelena ishte në kategorinë e dytë me trajner Lefter Shkëmbi. Për arsye familjare, shkon në Durrës pranë gjy-shes dhe dajave për të kryer shkollën e mesme te përgjithshme. Mësuesi i edukimit fizik, Lutfi Bagoi, në këtë shkollë dalloi menjëherë cilësi fizike shumë të mira tek Kushtrimi dhe e adresoi atë tek trajneri i të rinjve të “Lokomotivës” së Durrësit, Dhimitraq Goga. Stërvitjet në këtë ekip jo vetëm zhvilluan talentin e Kushtrimit, por bashkë me shokët e ekipit ata u shpallën kampion të të rinjve për tre vjet radhazi (1967-1969). Gjate këtyre viteve Kushtrimi u aktivizua edhe në shumë ndeshje me ekipin e të rriturve të “Lokomotivës” me trajner Bashkim Taga.

Kur dhe si jeni njohur me Kushtrim Zaçen?

Ambientet sportive ishin ato që na njohën dhe më lidhën me Kushtrimin. Këtë moment të njohjes në largësi e tregonte shpesh herë me miqtë Kushtrimi. Unë isha studente në vitin e dytë të ILKF “Vojo Kushi”, ndërsa Kushtrimi i sapo ardhur ushtar në klubin “Partizani”. Përballemi mbrapa pallatit të sportit “Partizani” pa ndonjë impakt të veçantë. Çuditërisht, pasi u larguam rreth 10 m, kthejmë kokën pas të dy në të njëjtën kohë. Kjo ishte shenja e parë e tërheqjes, megjithëse asnjëri nga ne nuk kishte dijeni për njëri-tjetrin. Më pas, gjatë orëve praktike të zhvilluara në anekset e pallatit të sportit dhe kontaktet shoqërore që u krijuan, natyrshëm edhe nëpërmjet shokëve të përbashkët atletë ne vazhduam ta përforconim këtë lidhje, e cila falë edhe alkimisë ishte një tërheqje e fortë. Kushtrimi pas njohjes kur e mori vesh kush isha unë, bëri lidhjen e emrit me rezultatet sportive të mia. Unë atëherë isha nga sportistët më të mira të vendit e shpallur gati çdo vit në 5 sportistët më të mirë të vitit. Ndërsa unë thjesht tani po e njihja Kushtrimin (një emër shumë i veçantë që ia kishte vënë një mik i babait të tij kosovar) si një djalë nga Tepelena, i cili bënte shërbimin ushtarak pranë klubit “Partizani”, si një nga talentet e reja në basketboll. Ajo që më tërhoqi qysh në fillim ishte serioziteti i tij dhe mbi të gjitha një tip i tërhequr që i pëlqente vetmia, përveç se dallonte për një personalitet të veçantë, por edhe simpatik. Ndërsa si basketbollist, falë aftësive fizike, por edhe vullnetit të tij, ai erdhi çdo ditë duke rritur performancën e tij sportive.

Sportistë të mëdhenj dhe bashkëshortë të pandarë



Aq sa unë u bëra një fansja e tij ashtu sikurse edhe Kushtrimi ndiqte garat e mija. Pas këtij momenti magjik ne filluam të kemi një tërheqje për njëri-tjetrin dhe ta kërkojmë më shpesh me sy njëri-tjetrin. Dalëngadalë filluam të rrinim, të pyesnim e bisedonim me njëri-tjetrin për t’u njohur dhe forcurar më shumë marrëdhënien tonë. Kishte filluar dashuria, e cila na bëri që të mos rrinim pa njëri-tjetrin. Dashurinë tonë e bëmë prezentë dhe në familjet tona, ku gjetëm edhe mbështetjen e tyre dhe pas një viti ne formatizuar lidhjen tonë me fejesë dhe më vonë pasi mbarova shkollën e lartë emërohem si asistent pedagog në Institut, ne bëmë kurorëzimin e dashurisë tonë me martesë. Ka qenë janari i vitit 1972.

Si erdhi Kushtrimi tek “Partizani”?

Edhe ky moment përbënte një ngjarje që Kushtrimit dhe familjes së tij i kishte lenë gjurmë jo të mira në subkosciençën e tij. Ëndrra e babait të tij, por edhe e tij ishte vazhdimi i shkollës së lartë dhe për këtë do ta ndihmonte edhe sporti. Pas përfundimit të gjimnazit “Gjergj Kastrioti” në Durrës, shokët e ekipit të basketbollit të Durrësit dhe drejtuesit e klubit “Studenti” e tërheqin atë në klubin “Studenti” për të luajtur, por edhe për të vazhduar shkollën e lartë. Ishte një ëndërr e tij që të vazhonte dhe shkollën. Babai ia kishte vënë si detyrë, si pikësynim kryesor shkollën. Ishte periudha e verës, kur të gjithë maturantët bënin plane për shkollën e lartë. Po kështu dhe Kushtrimi. Në këtë kohë, një ditë kur po bënte xhiro në Durrës, një tricikël i Degës Ushtarake (ku ishte një ushtar dhe një oficer) i ndalon te këmbët dhe oficeri i thotë do vish me

nga një pjesë e mirë e drejtuesve të Ministrisë së Mbrojtjes, të klubit sportiv dhe të trajnerëve e shumicës së lojtarëve, bëri që Zaça të fitonte një emër të madh, pse jo më vonë të realizojë edhe shkollimin e tij, tashme në atë të fushës së edukimit dhe sportit. Ai pati fatin e madh që të zhvillonte talentin e tij bashkë me të mëdhenjtë e basketbollit në atë kohë si Fagu, Mushi, Kuqo, Pëllumbi, Boshnjaku, Dheri, Prifti etj që pasuan këtë plejadë të mrekullueshme të basketbollit shqiptar. Tek “Partizani” ishin një grup djemsh shumë të përgatitur, shumë të motivuar dhe që bënin një stërvitje shumë profesionale. Dhe ishte fakt që mbështetja dhe trajtimi i këtij ekipi ishte shumë i mirë në raport me sportistët e klubeve të tjera.

Kush ishin të veçantat e tjera të ekipit të “Partizanit” në atë periudhë?

Kushtrimi luajti me një ekip që u kthye në simbol dhe ëndërr e bukur për të gjithë të rinjtë shqiptarë. Ata ishin jo vetëm lojtarë të talentuar, por edhe djem që dallonin për kulturën, sjelljen, përkushtimin ndaj sportit duke e privuar veten nga shumë gëzime të moshës. Ata stërviteshin me orë të tëra me ngarkesa të mëdha stërvitore, por mbi të gjitha edhe nën drejtimin e trajnerëve më të mirë të kohës si Astrit Greva, Qemal Shalsi dhe Njazi Lleshi. Ata shkëlqyen në arritjet e tyre duke u përballur si të barabartë me shumë nga ekipet europiane më në zë të kohës. Ekipi kampion “Partizani” i ka sjellë gëzime mijëra shikuesve me rezultatet në vend dhe në ndeshjet ndërkombëtare. Kulme të tilla si ajo me “Çepelin” e Hungarisë, “Vienbergerin” e Austrisë, Sparta “Bertranzhin” e Luksenburgut, “Aspo Tours” dhe “Caen” të Francës e shume epike të tjera nuk harrohen lehtë. “Partizani” ndryshoi basketbollin shqiptar, ai e ktheu lojën në fushë në një kombinim perfekt të vlerave individuale në ato kolektive, aq sa sportdashësit të entuziazmoheshin nga kombinacione

sa të bukura aq edhe rezultative. Vlera e këtij ekipi qëndronte edhe në atë të pasurimit të vazhdueshëm me elementë të rinj të talentuar dhe kështu tradita përcillej ndër më të rinjtë që me aftësitë e talentin e tyre çuan më tej cilësinë sportive. Lojtarë të rinj, shumë të talentuar si: Gazmend Çaçi, Pjerin Bushati, Artan Kuqo etj, u bënë shumë shpejt protagonistë të arritjeve të basketbollit të “Partizanit” dhe të atij kombëtar, me të cilët Zaça pati fatin të luante në vitet e fundit të karrierës së tij. Për aq kohë sa luajti me këtë skuadër thuhet se fituan gjithë kampionatet. Pra, që nga viti 1970 deri në 1982. Madje ky ekip ishte jo vetëm kampion në Shqipëri, por në ndeshjet ndërkombëtare për kupat e Europës ka arritur rezultate shumë të mira.

Sa vjet ka luajtur me “Partizanin” Kushtrimi?

Kushtrimi ka luajtur nga viti 1970-deri në 1981, pra afërsisht 12 vjet. Ka marrë pjesë në 12 kampionate dhe ka dalë 12 herë kampion dhe 10 herë fitues i Kupës së Republikës, rezultate që sot nuk mund të besohen. Dy herë fitues i Spartakiadave që zhvilloheshin çdo katër vjet. Por ai ishte modest në diskutimet dhe intervistat dhe nuk i nxirte në pah këto rezultate. Disa herë kanë kaluar turin e parë të kualifikimit për në Kupën e Europës dhe disa herë edhe turin e dytë, por e rëndësishme ishte që ekipi i “Partizanit” ka luajtur ndeshje shumë të mira në Tiranë me epike që ishin në krye të klasifikimit në Kupat e Europës.

Si ishte raporti talent-stërvitje tek Kushtrimi?

Ai ishte i talentuar sepse ishte daluar si i tillë që në fëmijëri, në bazë të cilësive fizike. Dallonte nga bashkëmoshatarët jo vetëm nga shtatëlartësia, por edhe nga shkathhtësia. Mbi të gjitha ai kuptoi që çdo rezultat pozitiv do vinte nëpërmjet punës, stërvitjes, gjë të cilën ai e bëri gjatë gjithë karrierës së tij sportive. E dinte që talenti venitet





pa stërvitje dhe përpiquej që të ishte gjithmonë korrekt me stërvitjen.

Talenti i tij e kishte bazën edhe nga vendi i origjinës, veç të tjerash ai ishte krenar për vendlindjen e tij, për historinë e saj. Si çdo fëmijë i moshës së tij ai i kishte zhvilluar aftësitë edhe falë pozicionit gjeografik dhe terrenit të thyer e plot bukuri të Tepelenës. Ai ishte i pasionuar pas historisë dhe krenohej me Ali Pashë Tepelenën, fotografinë e të cilit nuk e ndante, veç botimeve për të. Ai ishte rritur me ajrin e pastër të maleve, por dhe flladin e lumit të Vjosës dhe Drinos. Kushtrimi ishte dalluar në Tepelenë për këto cilësi dhe dëshirën e madhe për basketboll. Këto cilësi i pa mësuesi i tij, Lefter Shkëmbi, i cili e futi që 14 vjeç si lojtar në formacionin e të rriturve të Tepelenës që ishin në kategori të dytë. Por për fat të keq, lufta e klasave që zhvillohej aso kohe nuk e la as atë. Babain e dënojnë me dy vjet dhe ai detyrohet të shkojë tek të afërmit në Durrës, tek gjyshja dhe daja. Problemi i biografisë do ta ndiqte në raste të veçanta, por kurrësi s'mund të themi se iu bë jeta ferr. Ai përfaqësoi shume mirë Shqipërinë dhe ishte krenar për këtë ishte një patriot i lindur kur vinte fjala për shqiptarizmin. Ai me lojën e tij i dha krenari edhe Tepelenës që e rriti dhe e zbuloi si një basketbollist të ardhshëm, por edhe gjithë Shqipërisë.

Si e tregonte jetën ushtarake?

Kushtrimi ka punuar 5 vjet si instruktor i Edukimit Fizik në Shkollën e Instrukcionit në Zall-Herr. Për ata kohë ruante kujtimet më të bukura. Ai më tregonte për miqësinë mes oficerëve, për dashurinë dhe korrektesën e tyre, për respektin dhe dashurinë që kishin ata për Kushtrimin si njeri, por edhe si një sportist i madh i ekipit të ushtrisë siç ishte "Partizani". E ritheksoj se Kushtrimi ka kaluar pjesën më të bukur të jetës mes oficerëve dhe ushtarëve, ku ka gjetur një ambient tepër miqësor, njerëz të devotshëm, patriotë dhe të përgatitur. Në vitet që punoi në Zall-Herr Zaçja ishte në kulmin e e lavdisë së tij si basketbollist, por punës në këtë shkollë ushtarake ai nuk i shmangej kurrë, plot vështirësi, por anjëherë nuk ankohej, përkundrazi. Pastaj, e si mund të ndjehej keq atje, ai ishte mes ushtarëve dhe kursantëve që ishin edhe tifozët më të flaktë të "Partizanit" kampion, sidomos në basketboll e futboll.

Po më pas si ka kaluar jeta profesionale dhe sportive e Kushtrimit?

Pas largimit nga Zall-Heri erdhi

si mësues edukimi fizik në Tiranë, në Shkollën e Kuqe ku punoi me shumë pasion me klasat sportive të basketbollit duke transmetuar përvojën e tij. Ne vitet 85-92 ai ishte trajner i ekipit të meshkujve të "Studentit". Më pas, 1993-1997 ka qenë shef i përgatitjes fizike në trupat special RENE, e me radhë drejtor i Pallatit të Sportit "Asllan Rusi", drejtor i Agjencisë së Sportit. Gjithsesi, si shumë shqiptarë pas viteve 90 dhe ndryshimeve që ndodhën edhe Kushtrimi vuajti për disa vjet papunësinë.

A ka pasur pengesa për të shkuar jashtë për çështjen e biografisë?

Po ka pasur disa herë. Fillimin padyshim e ka përjetuar shumë keq. Ishte kur e kishin grumbulluar me ekipin e "Dinamos" për të shkuar në Kinë. Në momentin e fundit i thanë nuk do shkosh. U zhgënjye shumë, por ishte edhe një mësim për atë që e priste për të ardhmen. Mua s'më mbetej veçse ti jepja kurajë të mos mërzhitej. Ne ishim atëherë ne fillimet e lidhjes sonë, por kjo nuk ndryshoi asnjë gjë. Momenti i dytë ishte viti 1975, ku ishim të dy të grumbulluar me ekipet kombëtare, ai me basketbollin dhe unë me volejbollin. Aktiviteti basketbollit ishin dy javë më para se ne. Ishte viti kur sapo kishin kaluar ngjarjet e spastrimeve në ushtri. Pra, ishin dënuar shumë gjeneralë midis të cilëve edhe ministri i Mbrojtjes Beqir Balluku. Për çudi, në momentin e fundit Kushtrimin, por edhe disa lojtarë të tjerë i ndaluan për të dalë jashtë. Pas dy javësh edhe unë megjithëse isha titullare e ekipit kombëtar së bashku me disa vajza të tjera na u lexua lista që ndalohejshim të dilnim jashtë. Pra nuk shkuam të dy jashtë. Ishin ngjarje të zakonshme kur ashpërsohej lufta e klasave. Gjithësesi ne i dinim problemet që i ngrinin Kushtrimin në biografi dhe i kishim marrë parasysh, sepse dashuria jonë superonte mbi këto çështje. Unë qysh në fillim e kisha vendosur që dhe në Tepelenë të na çonin do shkoja aty me të. Por më vonë u zbut lufta e klasave dhe unë vazhdoja të jem pedagog në Institut dhe Kushtrimi mësues i edukimit fizik. Ne, në raport me arrijtet tona sportive, vazhduam të dilnim jashtë vendit me ekipet tona përfaqësuese dhe të arrijmë rezultate të larta. Së bashku me Kushtrimin ne ishim një çift korrekt që përpiquej të përbalonim të gjitha sfidat e jetës në punë e kudo dhe ti jepnim rëndësi të veçantë mirërritjes së fëmijëve që e realizonim

me shumë përkushtim e sakrificë, pasi edhe familjet tona prindërore i kishim larg. Ne kishim arritur një mirëkuptim shumë të mirë veçanërisht kur duhet të mbështesim njëri-tjetrin në raste të veçanta të grumbullimeve apo kualifikimeve pasuniversitare që mua më duhej të bëja.

Ndonjë ndeshje të veçantë?

Gjatë karrierës se tij 12-vjeçare me ekipin e "Partizanit" Kushtrim Zaçë ka veçuar disa ndeshje ku jo vetëm ka shkëlqyer, por ato kanë qenë të lidhura edhe me problemet e kohës apo edhe ato familjare. Kujtoj këtu një moment të vështirë të tij. Në vitin 1973 ekipi u grumbullua në Durrës për eliminatorët e Kupës së Kampionëve të Europës dhe shorti e kishte vënë "Partizanin" përballë ekipit hungarez "Cepel". Ndeshja e parë ishte në Hungari dhe Zaçja meqenëse kishte fëmijën sëmurë i kërkoi trajnerit lejë të merrte pjesë në seancat stërvitore, por të mos qëndronte në Durrës. Trajneri nuk e lejoi dhe

drejt kundërshtarit. Tifozët kur shihnin Zaçen në stol bërtisnin në korr "Zaçja, Zaçja! Futeni Zaçen!". Trajneri më së fundi u thye dhe e futi në pjesën e dytë. Ishte një sfidë dhe përgjegjësi e tij për të justifikuar besimin e atyre që e mbështetën dhe Zaçja vërtet shkëlqeu në këtë ndeshje. Vetëm në 20 minuta ai doli shënuesi më i mirë i ekipit, me 21 pike, kur të tjerët luajtën për 40 minuta dhe shënuan më pak. Ndeshja u nda me barazim. Një ndeshje tjetër shumë e veçantë ka qenë ajo e 16 tetorit 1979 me "CSKA" e Sofjes, një nga ekipet më të mira në Europë. Në Bullgari ekipi i "Partizanit" humbi, ndërsa në ndeshjen e kthimit në Tiranë Zaçja u kthye në një nga protagonistët e saj duke shënuar disa kosha që edhe sot janë në kujtesën e specialistëve dhe tifozëve të basketbollit. Ishte e pabesueshme. Trajneri i CSKA nuk u besonte syve. Atë ndeshje Partizani fitoi me 6 pikë para.

Cilët janë fëmijët tuaj dhe si është ndjerë Kushtrimi me lindjen



"Partizani" kampion për sezonin 1980-81

madje nuk e mori as në ndeshjen në Hungari, megjithëse Kushtrimi ishte titullar i ekipit. Ndeshja përfundoi me një pike diferencë në favor të hungarezëve (58-57). Në ndeshjen e kthimit në Tiranë nga drejtuesit e ministrisë u dha urdhër që Zaçja të luante, por trajneri përsëri nuk e aktivizoi në pjesën e parë. Rezultati i ndeshjes, ndryshe nga pritshmëria e të gjithëve, po shkonte

e tyre. Për kë është gëzuar më shumë?

Ne kemi lindur dy fëmijë, një djalë dhe një vajzë. Gëzimi i Kushtrimit ka qenë i njëjtë për të dy fëmijët. Ne i kemi fëmijët në një diferencë prej 7 vjetësh. Pra, vajza ka lindur e dyta. Kushtrimi si tepelenas donte që në familje të kishim dy djem, pasi të ruhej sa më e fortë

trashëgimia familjare. Por kurrësi nuk e zvogëloi gëzimin në lindjen e vajzës, përkundrazi. Edhe unë e doja fëmijën e parë djalë, pasi rridhja nga një familje me tre motra ku babai na la të vogla dhe na ka rritur nëna me shumë vështirësi. Më vonë doja vajzë dhe zoti na e plotësoi dëshirën. Pra, ne bëmë dy fëmijë shumë të mirë, dy fëmijë që na falën vetëm gëzim dhe nuk na kanë shqetësuar kurrë. Kushtrimi ishte një baba i përkushtuar dhe që kujdesej shumë për fëmijët. Kujdesej për mbarëvajtjen e tyre në mësimet megjithëse në takimet e prindërve isha unë ajo që merrja më shumë pjesë. Sidomos me Henrin ai është marrë shumë edhe për formimin e tij sportiv, i cili e filloi me futbollin dhe vazhdoi më pas basketbollin duke e stërvitur vetë. Pavarësisht se ata ishin babë e bir, pavarësisht se kishin diferencë moshe, thuajse ata u bënë si shokë. Largimi i djalit në emigracion në vitet e para të demokracisë e mërziti shumë. Ishte lidhur me të, me stërvitjen e tij. Ndërsa vajzën, Migenën, nuk e lidhëm me sportin pasi i dinim sakrificat e tij dhe duke qenë një nxënëse absolute e dhjetës ajo studioi për Ekonomi në Turqi, më pas u kthye në Shqipëri dhe tashmë ka familjen e saj.

Na thuaj diçka më shumë për djalin tuaj, Henrin?

Henri ka marrë pjesë në disa evente shume të rëndësishme, si fillim me kombëtaren e të rinjve e më pas me atë të të rriturve. Falë kohës që ai zhvilloi basketbollin (pas viteve 90), brenda një viti zhvilloi aq aktivitete ndërkombëtare sa kisha zhvilluar unë gjatë gjithë jetës sime sportive, pavarësisht se mund të kisha arritur normat e pjesëmarrjes. Ai u bë një sportist shumë cilësor, pavarësisht se basketblli nuk pati atë zenit që arriti në kohën e Kushtrimit. Por kujtoj shumë raste dhe shumë ndeshje ku Henri ka shkëlqyer. Një ndeshjen me ekipin e "Partizanit" kundër "Aris" të Selanikut të Greqisë, në vitin 1995 (mos gaboj), kur Zaçës junior iu dha detyrë të mbronte Galis, asokohe ai ishte cilësuar si një ndër lojtarët më të mirë në Europë. Mbrojtja që i bëri Henri Galisit ishte një surprizë për të gjithë, aq sa ai nuk arriti të bëjë lojën e tij. Me këtë lojë Henri tregoi se ishte një lojtar i talentuar dhe me një përgatitje shume të mirë fizike dhe teknike. Kushtrimi kishte qenë deri në këtë periudhë trajneri i tij, para se të vinte tek "Par-

tizani". Atë kohë Greqia ishte skuadra më e mirë në Europë. Por ishte fati i tij i keq që në moshën 23 vjeç bëri një trauma të rëndë të gjurit në Angli (ku luante me një ekip anglez) dhe karriera e tij sportive u ndërpre. Edhe për pak vite që luajti basketboll, Henri krijoi personalitetin e vet si lojtar, por gjithmonë duke pasur si drejtues dhe mentor babain e tij, Kushtrim Zaçen!

Psikologu ushtarak, risi që po vjen në FA

“Rivitalizimi i Njesisë për Mbështetje Psikologjike të FARSH”, projekt ambicioz dhe i domosdoshëm

Ky projekt është një bashkëpunim midis Ministrisë së Mbrojtjes dhe OSBE-së

ALBA MUSARAJ,
Toger RUDINA PINA
Psikologe, Spitali Ushtarak i FA

Ministria e Mbrojtjes është duke bashkëpunuar me OSBE dhe Njësinë Psikologjike të Forcave të Armatosura të Austrisë për projektin “Rivitalizimi i Njesisë për Mbështetje Psikologjike të FARSH”. Ky projekt synon përfaqësimin e ngritjes së kapaciteteve për ndërtimin e njesisë së mbështetjes psikologjike të FA. Gjithashtu, nëpërmjet këtij projekti synohet edhe siguri i mjeteve psikometrike të standardizuara për vlerësimin psikologjik në mënyrë profesionale të personelit ushtarak, seleksionimin e këtij personeli, që nga ushtarët profesionistë deri te oficerët, forcat speciale, të inteligjencës, personeli pilot etj. Aktualisht Forcat e Armatosura e ofrojnë shërbimin nëpërmjet psikologëve të vendosur në disa prej forcave/batalioneve kryesore, por projekti synon rritjen e standardeve dhe vënien më tepër në efikasitet të këtij shërbimi të vlefshëm për ushtarakët për të përmirësuar cilësinë e jetës së tyre, jo vetëm gjatë përditshmërisë, por edhe në misionet jashtë vendit.

Ky projekt ka filluar në prill të vitit 2015 dhe ka ndjekur një sërë etapash për zhvillimin e tij. Në këtë kuadër, në datat 28-29 tetor u zhvillua në ambientet e hotel “Sheraton” dhe të Ministrisë së Mbrojtjes takimi midis Drejtorisë së Arsimit dhe Përkujdesjes Sociale të Ushtarakëve në Ministrinë e Mbrojtjes, përfaqësuar nga drejtori Kujtim Kadzadej, komandantit të QPR, kolonel Leonard Çoku, psikologët e FA, përfaqësuesi i OSBE, Markus Puchëin, si dhe drejtorit të Njesisë të Mbështetjes Psikologjike të Forcave të Armatosura Austriake, kolonel Christian Langer.

Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi mbi Analizën e Boshllëqeve për mbështetjen psikologjike në FA, rrahja e mendimeve mbi veprimet që duhen të ndërmerren për ringritjen e efikasitetit të saj, vendosja për zbatimin me prioritet të rekomandimeve të dhëna nga pala eksperte austriake për një përfaqësim të mundshme me modelin austriak, rekomandime këto të dhëna nga koloneli Langer, etj. Në takim ishin ftuar të merrnin pjesë edhe komandantët në nivel batalioni, përfaqësues të Drejtorisë J1, të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, Spitali Ushtarak i FA, Policisë Ushtarake, të cilët shprehën mendimet, nevojat, mbështetjen dhe vullnetin e tyre për të kontribuar në ringritjen e kësaj njësie. Në përfundim të takimit, u diskutuan pritshmëritë dhe hapat që do të ndërmerren në



vazhdim të këtij projekti, ndërtimi i një strategjie për funksionimin e kësaj njësie sipas standardeve të duhura, reformatimi strukturor, si dhe rritjen e ndërgjegjësimit për nevojën e një njësie funksionale për mbështetjen psikologjike të FARSH.

Koloneli Christian Langer dhe përfaqësuesi i OSBE, Markus Puchëin, u pritën edhe nga drejtori i Drejtorisë së Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralbrigade Nazmi Cahani, gjatë së cilës u prezantua edhe projekti.

Misioni i shërbimit psikosocial në FARSH

Ushtarakut aktiv në FARSH, gjatë ciklit jetësor të shërbimit, që prej vitit 2011 i ofrohet edhe mbështetje psikosociale për të përballuar problematikat psikologjike me të cilat ndeshet gjatë karrierës së vet ushtarake. Vizioni i këtij shërbimi është dhe përmirësimi e përsosja e politikave mbështetëse dhe shërbimeve, si dhe krijimi i një profili të qëndrueshëm të mbështetjes psikosociale profesionale për komunitetin e ushtarakëve, me qëllim që të plotësojë në kohë nevojat e FA dhe familjeve të tyre. Shumëllojshmëria e operacioneve ushtarake në përgjigje të krizave gjatë viteve të fundit në vende të ndryshme të botës, për periudha të shkurtra apo të gjata, ka bërë që të rritet dukshëm nevoja për mbështetje psikosociale të personelit ushtarak në misionet dhe të familjeve të tyre në vend. Detyrimet për një angazhim të vazhdueshëm në misionet luftarake e jo-luftarake në vende shumë të largëta, kompleksiteti i veprimeve luftarake dhe i mjedisit ku kryhen, të cilat shoqërohen me ngarkesë psikologjike si për ushtarakun dhe familjen e tij, kërkojnë mbështetje profesionale për të lehtësuar sa më shumë këtë proces. Nga një këndvështrim i pastër i menaxhimit ushtarak, organizimi i mbështetjes psikosociale është bërë një domosdoshmëri, pasi

edhe në terma afatshkurtër, mungesa e një mbështetjeje të tillë mund të krijojë ndikime negative në aspektin e gatishmërisë operacionale të ushtarakëve, ndërsa në terma afatgjatë, mund të ketë efekte negative, të tilla si: ulja e numrit të prurjeve të reja në rekrutim, por nga ana tjetër, kjo mund të sjellë rritjen e numrit të atyre individëve, që nuk e përballojnë dot shërbimin dhe si rrjedhojë e braktisin atë. Situata aktuale në FA krahasohet me standardet ndërkombëtare dhe me mësimet më të goditura që u nxorën gjatë një vizite studimore pranë Shërbimit Psikologjik Ushtarak

Austriak, në prill të këtij viti.

Misioni i shërbimit psikosocial në FARSH është të sigurojë me shërbime mbështetëse vlerësuese, këshilluese dhe rehabilituese, duke lehtësuar dhe trajtuar problemet psikologjike që mund të ndikojnë në mirëqenien emocionale dhe shëndetin mendor të ushtarakut dhe familjes së tij si dhe të mbështetë ri-integrimin e ushtarakëve pas kthimit nga misionet. Objektivat e shërbimit psikosocial në FARSH janë: siguri i mbështetjes psikologjike gjatë gjithë ciklit të karrierës ushtarake nëpërmjet njohjes dhe identifikimit në kohë të nevojave dhe problematikës që mund të ndikojnë në mirëqenien emocionale dhe shëndetin mendor të ushtarakëve; mbajtja e personelit ushtarak në gjendje të mirë mendore dhe emocionale për kryerjen e shërbimit apo realizimin e detyrave në FA; motivimi i ushtarakëve në mision nëpërmjet mbështetjes së nevojave të tyre psikosociale dhe kujdesit të drejtpërdrejtë për ta dhe familjet e tyre. Psikologu ushtarak është profesionist i shëndetit mendor me detyrë parësore të menaxhojë çështje që kanë të bëjnë me strukturat ushtarake. Psikologët janë të rëndësishëm për shumë struktura ushtarake, pasi mund të asistojnë edhe në identifikimin e kandidatëve për detyra specifike, të analizojnë rrezikun e stresit të luftimit apo situatave të tjera të lidhura me të dhe të ndihmojnë në rritjen e motivimit apo moralit brenda njësisë. Psikologu ushtarak përfshihet në njohjen, ruajtjen dhe mbajtjen e shëndetit mendor dhe emocional të anëtarëve të shërbimit ushtarak. Stresi i luftimit dhe të shërbyerit në një strukturë ushtarake mund të shkaktojë efekte të padëshirueshme psikologjike të njerëzimit, që ndikojnë në një shkallë më të gjerë në gjithë mbarëvajtjen institucionale. Psikologu ushtarak duhet të shpenzojë më tepër kohë për parandalimin sesa trajtimin e problemeve. Objektivi kryesor i

punës së psikologut ushtarak është të mbajë individët ushtarakë në gjendje të mirë mendore dhe emocionale për shërbimin apo realizimin e detyrave në FA.

Drejtorja e Arsimit dhe Përkujdesjes Sociale të Ushtarakëve në Ministrinë e Mbrojtjes ka si mision hartimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave strategjike të arsimit, të planeve dhe programeve arsimore për kualifikimin dhe arsimimin e personelit ushtarak dhe civil si dhe hartimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave të përkrahjes sociale, psikosociale dhe financiare të ushtarakëve aktivë, në rezervë, lirim, pension dhe të veteranëve të luftës. Specialisti psikolog, i cili është pozicionuar në Sektorin e Përkujdesjes Sociale të Ushtarakëve, ka si mision drejtimin e punës për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave të përkrahjes sociale, psikosociale, integritetit gjinor e financiar të ushtarakëve aktivë, në rezervë, lirim, pension dhe të veteranëve të luftës, në përputhje me kuadrin ligjor dhe standardet ekonomiko-sociale si dhe përmirësimin e standardeve për mbrojtjen, promovimin e të drejtave, rolit dhe pjesëmarrjes së personelit ushtarak sipas parimit për shanse të barabarta në përzgjedhje, punësim, përparim në gradë e karrierë, arsimimin e trajnim të personelit.

Procedurat e përzgjedhjes përfshijnë vlerësimin psikologjik gjatë rekrutimit të trupave profesionale; përzgjedhjen apo vlerësimin psikologjik të personelit pjesëmarrës në operacione jashtë vendit; përzgjedhjen/vlerësimin e ushtarëve profesionistë për avancim në gradë. Mbështetja psikologjike mundëson përgatitjen psikologjike të diferencuar të ushtarakëve para misioneve, si një komponent i domosdoshëm i trajnimit të përgjithshëm, me qëllim rritjen e shkallës së funksionimit gjatë ushtrimit të detyrës dhe përballimit të sfidave psikologjike; vlerësimin psikologjik dhe ri-integrimin në jetën sociale pas kthimit nga misioni; trajtimin psikologjik të diferencuar për rastet me PTSD dhe probleme të tjera psikologjike; këshillimin dhe mbështetjen psikologjike për të gjithë personelin e FARSH, i cili shfaq ose raporton probleme me sjelljen apo shëndetin mendor; përmirësimin e aftësive për të menaxhuar stresin në mënyrë efektive, nëpërmjet trajnimeve në grup dhe këshillimeve individuale. Edukimi dhe trajnimi psikologjik përfshin disa orë leksion mbi mbështetjen psikologjike në FA dhe teknikat e reduktimit të stresit në kursin njëmuor të personelit; vlerësimin e kurrikulave të trajnimit dhe edukimit me synim përfshirjen e komponentit psikologjik në kurrikulën e përgatitjes së FA.



Psikologu ushtarak është profesionist për njohjen, ruajtjen dhe mbajtjen e shëndetit mendor dhe emocional të anëtarëve të shërbimit ushtarak. Objektivi kryesor i punës së psikologut ushtarak është të mbajë individët ushtarakë në gjendje të mirë mendore dhe emocionale për shërbimin apo realizimin e detyrave në FA.

Kushtuar dëshmorëve të Br.XXIV S,
me rastin e 71-vjetorit të rënies së tyre

Nga kolonel © Sali ONUZI

Mu te “Kthesa e Kamzës”, në dy pllaka të thjeshta mermeri, janë gdhendur emrat e shtatëmbëdh-jete ish-partizanëve të Brigadës XXIV S, që ranë në luftën për çlirimin e Tiranës. Po veç këtyre dëshmorëve, nga kjo njësi partizane, në betejën për çlirimin e kryeqytetit ranë edhe nëntë luftëtarë të tjerë në pozicione të tjera, majtas e djathtas, nga ish-autoreparti (sot Instituti Harry Fultz) dhe deri në kodrat e Domjeve.

Këta janë :

1-Abaz Tahir Peposhi, Lusën

2-Dervish Hasan Hasani

Bardhaj, Dibër

3-Elmaz Hasan Ademi, Bardhok

4-Gani Hajdin Duraku, Morinë

5-Hakik Sherif Gjici, Bushtricë

6-Idriz Nuri Gafurri, Çajë

7- Maliq Imer Topuzi

Lashkizë, Dibër

8-Nuredin Tahir Braha, Canaj

(Bicaj)

9-Osman Halit Qinani, Arrën

10-Ramadan Muharrem

Kotarja, Gjegje

11-Ramadan Hamit Shahu, Bardhok

12-Sabri Islam Gjici, Bushtricë

13-Sadik Tahir Palushi, Palushe

14-Shefit Mehmet Smana, Çajë

15-Vehbi Ramadan Shehu,

Canaj (Bicaj)

16-Xheladin Nuredin Mici, Gjegjën

17-Maksut Rexhep Fetishi, Shishtavec

Në këtë listë, si në rreshtimin luftarak 71-vjet me pare, janë bashkë lumjanë, goranë, dibranë e malzias, të gjithë shqiptarë, patriot, djem të rinjë, që të kujtojnë formacionet e gjyshërve të tyre që kishin luftuar e fituar bashkë kundër ushtrisë push-tuese serbe në nëntor 1912, si sot 103 vjet më parë në betejën e famshme të Lumës.

Lufta 19 ditore për çlirimin e Tiranës është një epike e lavdishme e popullit dhe e Ushtrisë Nacional-clirimtare. Ajo kishte nisur që më 29 tetor 1944. Me 11 nëntor 1944 kjo luftë po hynte në fazën e saj përfundimtare. Brigada 24 S ishte thirrur me urdhër të Komadecë së Përgjithshme të merrte pjesë në këtë betejë të madhe. Ajo ishte një brigadë e re, një muaj e një javë nga krijimi i saj. Kronika e luftimeve të saj përmbante një pritë kundër forcave gjermane në rrugën Kukës-Prizren dhe një marshim të sforcuar tre ditë nga Luma në Mat e në Tiranë, ku arriti me datën 10 nëntor 1944. Po vinte të merrte pjesë në çlirimin e kryeqytetit dhe po rreshtohet përkrah njësisë të mirënjohura të Ushtrisë NÇI, Brigadës së I, IV, VIII, XV, XVII, X dhe të XXIII Sulmuese. Rajoni i luftimeve i Brigadës 24 S shtrihej nga Autoreparti (sot instituti “Harry Fultz”)Lapraka deri në kodrat e Domje me thellësi deri në Laknas, në krahun e djathtë të rrugës, midis Brigadës I dhe Brigadës XXIII S, që luftonte nga Vora e më tej. Përballë saj, në anën tjetër të rrugës, ishte Brigada X S dhe batalioni “Antonio Gramshi”.

Detyra e tyre ishte të bllokoni hyrjen dhe daljen e forcave gjermane nga Tirana.

Në Tiranë mbrohej një ganizon i fuqishëm gjerman, i pajisur me tanke,

Gjokset kundër tankeve fashiste



autoblinda dhe artileri të rëndë. Në përfocim të tij, në tërheqje e sipër, me 11 nëntor doli nga Elbasani një grupim tjetër i madh, sipas dokumenteve gjermane, i përbërë nga 5000 ushtarë dhe oficerë, 2000 prej të cilëve morën rrugën e Qafë Krrabës për në Tiranë dhe 3000 të tjerë për në Durrës e Vorë. Grupimi “Steyrer” që zbriti në Ibë e Mushqeta, u rrethua nga Brigada e XVII, IV, VIII dhe XV Sulmuese, të cilat në 15 nëntor gati e asgjësuan tërësisht këtë grupim dhe vetëm rreth 500 prej tyre u futën në Tiranë.

Ndërkohë nga Vora niseshin grupe të fuqishme për tu futur në Tiranë. Për të penguar depërtimin e këtyre forcave naziste në Tiranë Brigada XXIV dhe X S kishin ndërtuar barrikada në rrugë. Tanket gjermane pasi i gjuanin barrikadat me predha, sulmonin për t’i shkatërruar fizikisht me peshën e tyre të blinduar. Kronikat e kohës thonë se vetëm në një rast forcat gjermane mundën të hyjnë nga Vora në kryeqytet të përgjysmuar, në rastet e tjera u kthyen mbrapsht. Edhe ato mësynin për të dalë nga Tirana

nuk ia dolën dot deri me 16 nëntor në mbrëmje. Në këto ndeshje të egra me tanket gjermane partizanët e Br. 24 S luftonin me armët e këmbësorisë, me ndonjë granatë e rrallë ndonjë anti-tank. Luftimet ishin të ashpëra dhe të përgjakshme. Tipik është luftimi dhe rënia e komandantit të kompanisë



së dytë, Vehbi Shehut dhe dy partizanëve të tjerë, Nuredin Brahës dhe



Sadik Palushit. Komandanti i Brigadës 24 S, Ndreko Rino në kujtimet e tij shkruan: “Nata që e kthjellët, me hënë dhe e ngrohtë si natë pranverore. Pas pak u dëgjua zhurmë motorësh dhe në fillim dolën disa tanke, pastaj u pa një kolonë e madhe naziste, që vinte nga autoreparti në drejtim të kodrave të Kasharit. Armiku u la të futej i tëri në pritë dhe u hap zjarr i befasishëm. Mirëpo edhe ai filloi të kundërveprojë me zjarr duke çarë me anë të tankeve. Pranë rrugës, në një bunker të vjetër, të ndërtuar nga ushtria italiane, ishte Vehbi Shehu, komandant kompanie me dy partizanë. Të tre trimat, me tu afruar kolona naziste, filluan të hapin zjarr me pushkë kundërtanke dhe me armët e tjera mbi tanket dhe makinat me ushtarë nazistë. Tanku i parë mori flakë dhe ngeci në vend, mirëpo i dyti, e krahmoni të parin dhe u nis drejt bunkerit, i ra atij me hundë dhe e shembi. Kështu grupi që e mbronte u detyrua të dalë jashtë e të sulmojë me bomba dore. I pari iu turr tankut Vehbiu, por zjarri i tij dhe i nazistëve që ishin hapur majtas dhe djathtas e rrëzuan të vdekur për tokë. Mbas Vehbiut ranë edhe dy shokët e tjerë...

Qëndresa e brigadës në këtë pritë ishte e ashpër. Këtu gjoksi partizan u mat me kullën e çeliktë të tankeve të armikut”, - shkruan Ndreko Rino (“Ditë lufte”, 1978, f.68-69).

Ndërsa bashkëluftëtari i së njëjtës llogore me to, Sadik Kërzhaliu, vijon më tej tregimin e tij: “Togkomandanti Nuredin Braha dhe pas tij Sadik Palushi, u hodhën në sulm kundër tankeve, qëllonin me bomba dore dhe përparimi i tyre u bllokua. Nuredini mori në krah komandant Vehbiun për ta tërhequr, por sa u ngrit në këmbë u godit me dy predha (njëra në kokë dhe tjetra në anën e djathtë të gjoksit). Megjithatë ai ecte duke u lëkundur e i larë në gjak. Në ndihmë i shkoi Sadiku, por edhe ky ra i vdekur nga plumbat e armikut. Nuredini bëri disa hapa, por nga plagët e rënda dhe pesha e komandantit që mbante në krah ra përtokë përpara pozicioneve ku po luftonte ...e gjithë kompania jonë.

Barrikadën tonë lumjane nazistët nuk e kaluan dot”.

Kështu ranë si trimat 17 partizanët e Brigadës XXIV S.

Një kronikë interesante për qëndresën dhe rënien heroike të tyre e jep vetë komandanti i shtabit operativ për çlirimin e kryeqytetit, kolonel Mehmet Shehu në librin e tij “Lufta për çlirimin e Tiranës” për njërin nga këta dëshmorë: “Në pozitë tona te Burgu i ri është plagosur një partizan, - shkruan Shehu, - Maksut Rexhepi nga Luma (në fakt nga Shishtavec). S.O) qëllon me antitank pa rreshtur pozitë e armikut për të lehtësuar tërheqjen e shokut të plagosur. Në këtë kohë arrijnë tetë tanke për tu çelur rrugën gjermanëve të rrethuar. Detyra e Maksutit në këtë rast është e rëndë. E gjithë skuadra po rrethohet. Maksuti sjell antitankun kundër tankeve armiq dhe, duke qëlluar panderprerje lehtëson kalimin e skuadrës partizane. Ky gjest i kushtoi jetën: duke kaluar shokët e fundit, Maksuti vritet nga tanket armiq.” (f.79).

Me 23-28 nëntor 1944 Brigada XXIV S do të angazhohej për çlirimin e Shkodrës, kryeqendrës historike të Veriut dhe terreni i saj i luftimit do të ishin kodrat e Bërdices dhe të Beltojës, përballë mbrojtjes së fortifikuar gjermane dhe artilerisë së rëndë të vendosur në Kalanë e Rozafës. Në portat e Shkodrës ranë edhe 5 partizanë të tjerë të kësaj brigade:

1-Emri Metush Halilaj nga Canaj, Bicaj

2- Hasan Hysen Lika nga Lusna

3- Islam Ramdan Xhahu, nga Gjegjini

4-Isuf Jashar Seferi, nga Fshati

5- Imer Ramadan Mata nga Zapodi

Brigada XXIV S, që nuk pati kohë të parakalonte në Tiranë me 28 nëntor, parakaloi me 29 nëntor në Shkodrën e çliruar. Me pjesëmarrjen në çlirimin e Tiranës dhe të Shkodrës, me 22 dëshmorët e saj, kjo njësi partizane e kaloi me sukses provën e saj historike, duke kaluar e luftuar edhe përtej kufijve të saj lokal, krahinor, siç kishin bërë paraardhsit e saj dikur duke luftuar në Qafë Duhle, në Gryken e Cërnavës, në Kaçanik e deri në Shkup, për të cilët kënga popullore thotë :

*Djemtë e Lumës s'po kanë dert,
se ka' i luftë e bëjnë për vjet,
luftë më kraj e luftë me mbret.*

Këtë shkrim përkujtimor po e mbyll me fjalët e shkrimtarit tonë të madh Ismail Kadare, në një intervistë dhënë vjet në pranverë për gazetën “Zëri” në Prishtinë: “Është përkujtimi i një lufte dhe i martirëve të saj. Lufta ka ndodhur vërtet. Të vrarët kanë ikur nga kjo botë vërtet. Ndonëse ndihmesa e Shqipërisë në përplasjen botërore ka qenë modeste, pjesëmarrja ka qenë në nderin e saj. Kjo është e vërteta që jep historia”.

Dhe në këtë histori të Luftës Antifashiste Nacionalclirimtare lumjanët kanë pjesën e tyre të shkruar me luftë e me gjak në dy nga betejat më të mëdha të UNCSH, për çlirimin e Tiranës dhe të Shkodrës.

MIMOZA GOLIKJA

Vëzhgues të vendeve anëtare të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), si dhe vëzhgues nga vende të tjera nga e gjithë bota, u ftuan për të qenë dëshmitarë të stërvitjes më të madhe ushtarake të NATO-s, “Trident Juncture 2015”, e zhvilluar në Itali, Spanjë dhe Portugali. Kjo stërvitje ushtarake është stërvitja më e madhe e NATO-s për më shumë se një dekadë, e cila përfundon më 6 nëntor 2015.

Sipas Dokumentit të OSBE-së të Vjenës të vitit 2011, stërvitjet, duhet të njoftohen për shtetet anëtare të OSBE-së 42 ditë përpara nëse i kalon 9.000 trupat, si dhe për vëzhgimin, që kërkohej duke filluar nga 13.000 trupa. Aleatët e NATO-s i respektojnë këto kushte. Lidhur me këtë, sipas Dokumentit të Vjenës të vitit 2011, tre ekipe të veçanta të inspektimit rus arrihen javën e kalur në Itali, në Portugali dhe në Spanjë, pikërisht në vendet pritëse të stërvitjes Trident Juncture, gjatë zhvillimit të saj. Në çdo vend, ekipet u siguruan me informime rreth stërvitjes “Trident Juncture 2015” dhe inspektuan aktivitetet ushtarake që u kryhen në kuadër të kësaj stërvitje. Inspektimi në Itali u zhvillua nga datat 26 deri në 28 tetor, kurse inspektimet në Spanjë dhe Portugali në datat 27 deri në 29 tetor.

Gjithashtu nën rregullat e Dokumentit të Vjenës 2011, vëzhgues nga Gjermania, Rusia, Suedia, Zvicra dhe Shtetet e Bashkuara vizituan Spanjën nga data 1 deri në 4 nëntor, pasi ishte vendi ku ishin dhe përqendrimet më të mëdha të trupave gjatë stërvitjes. Ky program vëzhgues i aktiviteteve ushtarake ishte koordinuar me Spanjën dhe celulën e Koordinimit për Kontrollin e Armëve Konvencionale të NATO-s.

“Trident Juncture tregon përkushtimin e aleancës ndaj transparencës dhe parashikueshmërisë në veprimtaritë ushtarake”, tha gjenerali Hans-Lothar Domröse, Komandant i Forcave të Përbashkëta të Komandës Brunsum të NATO-s dhe i stërvitjes. “E kam pritur me kënaqësi që disa vende zgjedhën për të dërguar vëzhgues në “Trident Juncture 2015”. Kjo stërvitje është me natyrë mbrojtëse, ku skenari dhe kundërshtari janë të trilluar. Shpresojmë se duke i ftuar vëzhguesit ne, të mund të ndihmojmë për të ndërtuar besimin dhe sigurinë”. Stërvitja Trident Juncture është stërvitja më e madhe dhe më ambicioze e Aleancës në më shumë se një dekadë. Ajo përfshiu 36.000 trupa në det në tokë dhe në ajër, nga më shumë se 30 kombe, si dhe certifikoi selinë e Forcës së Reagimit të NATO-s dhe funksionin e ri të Gatishmërisë shumë të Lartë të Forcës së re majë shtize.

“Mbi krahët” e Trident Juncture 2015

Ekipet e Forcave Ajrore të aleatëve dhe vendeve partnere u trajnuan për të përmirësuar gatishmërinë e tyre dhe aftësinë për të punuar së bashku dhe bashkëvepruar me Forcat Tokësore dhe Forcat Detare gjatë stërvitjes “Trident Juncture 2015” të NATO-s. Më shumë se 160 avionë luftarakë, duke përfshirë avionët depozitë të karburantit, avionët e transportit, helikopterët, aeroplanët e mbikqyrjes dhe dronet, u trajnuan në stërvitje dhe vepruan në 15 bazat ajrore në Itali, Spanjë, Portugali, tre vendeve aleate pritëse të stërvitjes “Trident Juncture 2015”.

Gjashtëmbëdhjetë aleatët dhe tre vendet partnere dërguan ekipet dhe aeroplanët për të marrë pjesë në stër-

Transparencë dhe parashikueshmëri, “Trident Juncture 2015” e hapur për vëzhguesit ndërkombëtarë



vitjen ushtarake, që filloi më 19 tetor. Operacionet e përbashkëta ajrore u përqendruan në lloje të ndryshme të misioneve, duke përfshirë trajnimin për operacione ajrore mbrojtëse dhe sulmuese dhe praktikuan furnizimin me karburant në ajër, kërkim shpëtimin, mbështetjen ajrore për forcat tokësore dhe detare, si dhe operacionet taktike të transportit ajror. “Nga data 21 tetor deri më 28 tetor ka pasur rreth 340 fluturime në mbështetje të operacioneve ajrore nga Beja në Portugali ku përfshinë avionët F-16 të Forcës Ajrore portugeze, duke siguruar asetet ajrore të simulura nga Monte Real, AÉACS (mbikëqyrjen) dhe Mbështetjen e marrë nga Torrejón, Spanja”, tha koloneli i Forcave Ajrore helene Georgios Giapitzis, Kryetari i Kontrollit të Operacioneve lokale në Beja, Portugali, gjatë stërvitjes “Trident Juncture 2015”.

Në përgatitje, vendet pritëse, vendet që kontribuan me trupa dhe organizimin dhe komandat e NATO-s, koordinuan ngushtë me homologët civilë të kontrollit të trafikut ajror, duke përfshirë EUROCONTROLL-in, Organizatën Evropiane për Sigurinë e Navigacionin Ajror, për të siguruar përdorimin e sigurt dhe menaxhimin e hapësirës ajrore gjatë stërvitjes Trident Juncture. Komponenti i ajërit i Stërvitjes Trident Juncture të vitit 2015, u drejtua nga Komanda Ajrore Aleate e NATO-s në Ramstein, Gjermani. Operacionet ajrore taktike u kontrolluan nga Komponenti i Forcës Ajrore të Përbashkët italiane në Poggio Renatico në pjesën veriore të Italisë. Ata koordinuan ngushtësisht me njësitë e kontrollit të operacioneve lokale në Trapani në Itali, Albacete në Spanjë dhe Beja në Portugali, si dhe me trupat e vendeve pritëse dhe trupat e kombeve kontribues.

NATO dhe partnerët vënë në provë aftësitë detare

Nëntëmbëdhjetë ishin kombet e NATO-s, që kontribuan në flotën dhe Forcat Detare për Stërvitjen “Trident Juncture 2015”, Më shumë se 70 anije dhe nëndetëse, aeroplanë të patrullimit detar dhe 3.000 marinsa ishin pjesë-

marrës në pjesën detare të stërvitjes që u zhvillua në brigjet e Portugalisë, Spanjës dhe Italisë, si dhe në Komandën Detare të NATO-s në Mbretërinë e Bashkuar.

“Jam i kënaqur që jam në këtë ushtrim të vështirë të NATO-s me njësitë e mia, duke parë përpara në të ardhmen, për të trajnimin me këto ekipet shumë të motivuara nga kombe të ndryshme. Multi-kombësitë janë frymëzuese. Procedurat e zakonshme dhe taktikat janë të rëndësishme për formimin e një force koherente dhe të aftë të NATO-s në det”, tha admiral Jorg Klein, komandanti i Grupit të Dytë të Përhershëm Detar të NATO-s. Tri javët e trajnimit intensiv filluan më 19 tetor gjatë ceremonisë së hapjes në bazën Trapani të Forcave Ajrore në Itali.

Një grup i gjerë i aleatëve ishin të përfshirë në manovrat e trajnimit dhe teknikat gjatë ditëve të para të ushtrimit. Forcat detare holandeze dhe britanike kryen operacione amfibe në Sierra del Retin, Spanjë. Në Sardenjë, Itali, marinsat amerikanë dhe britanikë të Marinës Mbretërore, u trajnuan

së bashku për të rritur ndërveprimin e tyre e cila është vendimtare për të siguruar që ata mund të punojnë së bashku në situata krize. Anijet detare kanadeze, portugeze, spanjolle dhe daneze kryen operacione në Oqeanin Atlantik në jug të Portugalisë.

Ndërkohë dy avionë luftarakë portugezë F16 dhe katër avionë luftarakë F18 nga vendi partner Finlanda, mbështetën

trajnimin detar nga ajri. “Kjo ishte një mundësi e vlefshme trajnimi e luftës anti-ajër që na lejon të vëzhgojmë aftësitë mbresëlënëse ajrore të aleatëve tanë të NATO-s”, tha komandanti Pascal Belhumeur, zyrtar i komanduar kanadez i Fregatës HMCS Winnipeg.

Pjesa detare e Stërvitjes “Trident Juncture 2015”, testoi disiplina të shumta luftarake në det, duke përfshirë: zbarkime amfibe në katër lokacione, aktivitete të veçanta në Forcat e Operacioneve Detare, fluturime të avionëve patrullë, nëndetëse luftarake dhe trajnime bregdetare. Trident Juncture përfundon më 6 nëntor në Itali, Spanjë dhe Portugali. Stërvitja që përfshin 36.000 trupa nga më shumë se 30 kombe, do të vërtetojë selinë e vitit të ardhshëm Forcës së Reagimit të NATO-s dhe funksionin e ri të Gatishmërisë shumë të lartë të Forcës majë shtize.

Komponenti i Forcave Tokësore në “Trident Juncture 2015”

Vënia në provë e aftësive të Forcave Tokësore të NATO-s gjithashtu ishte

pjesë e zhvillimit të stërvitjes “Trident Juncture 2015”.

Forcat Tokësore nga 16 vende aleate të NATO-s morrën pjesë në stërvitje së bashku me Forcat Ajrore, Detare dhe forcat e veçanta operative për të përmirësuar gatishmërinë e tyre dhe aftësinë për të punuar së bashku në një gamë të gjerë të aftësive.

Manovrat e Forcave Tokësore mbulonin një fushë të gjerë të stërvitjes, si kimike, biologjike, radiologjike dhe kundër ndotjes bërthamore (të përbëra nga një Batalion prej nëntë vendesh) përmes operacioneve luftarake urbane (kryer nga Batalioni Baltik, i përbërë nga ushtarakët nga të tre shtetet baltike) për trajnimi artilerie dhe hedhje ajrore me paratrupa spanjolle, italiane dhe kanadeze.

Spanja, Italia dhe Portugalia, kombet pritëse të stërvitjes, ishin ato që ofruan bazat e trajnimit për operacionet tokësore të stërvitjes. Demonstrimi i aftësive të Forcave Tokësore të NATO-s u dha më 4 nëntor në Zonën e Trajnimit San Gregorio në Spanjë. Forcat nga 12 aleatët e NATO-s kryen një operacion që përfshinte një peng shpëtimi, pastrimin fushë të minuar dhe sulme të këmbësorisë. Sulme dhe ngarkesa të helikopterëve, duke përfshirë Apache të SHBA, Chinooks dhe Blackhawks që kryen misione në mbështetje të demonstrimit të përgjithshëm. Aeroplanët luftarakë luajtën një rol ngushtësisht mbështetës ajror të trupave në terren gjatë demonstrimit.

Trident Juncture trajnoi dhe certifikoi Shtabin e Forcës së Reagimit të NATO-s (NRF) për vitin 2016 si dhe testimin e elementeve të forcave spanjolle që do të përcaktojnë avantazhin e Gatishmërisë Shumë të Lartë të Task Forcës së Përbashkët (VJTF) të NATO-s, ose Forcës majë shtize, përpara bërjes së saj plotësisht operacionale vitin e ardhshëm.

Stërvitja përfshiu më shumë se 230 njësi, më shumë se 140 avionë dhe më shumë se 60 anije.





Aftësitë e NATO-s janë reale dhe të gatshme

Fjala e Sekretarit të Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg në konferencën e përbashkët për shtyp me ministrin spanjoll të Mbrojtjes, Pedro Morenes Eulate, në Ditën e vizitorëve të shquar në Zaragosa, Spanjë në Trident Juncture 2015

Faleminderit ministri Pedro Morenés dhe delegacioni që vjen nga selia e NATO-s në Bruksel. Është me të vërtetë një përvojë e madhe që jam këtu bashkë me ju sot. Ju falënderoj për mikpritjen tuaj.

Por më lejoni të filloj duke nderuar tre oficerët ushtarakë të Forcave Ajrore spanjolle, të cilët kohët e fundit humbën jetën në ujërat e Atlantikut. Ngushëllimet më të sinqerta shkojnë për familjet e tyre, kolegët e tyre dhe për Qeverinë spanjolle.

Ne nderojmë përkushtimin e burrave dhe grave tona në uniformë. Ne jemi mirënjohës për çdo gjë që bëjnë për të na mbajtur të sigurt. Në misionet, operacionet, dhe ushtrimet.

Më lejoni të falënderoj Spanjën për punën e madhe që është bërë në bashkëpunim të pritjes së stërvitjes Trident Juncture 2015, së bashku me Italinë dhe Portugalinë. Spanja është e përkushtuar fuqishëm për sigurinë tonë të përbashkët. Ju jeni duke dhënë një nga kontributet më të mëdha për ushtrimin, me trupa, tanke, aeroplanë dhe anije. Kjo është një mundësi e madhe për të përgatitur kontingjentin spanjoll për të udhëhequr Forcën majë shtize të Gatishmërisë shumë të Lartë të NATO-s në vitin 2016.

Trident Juncture është stërvitja më e madhe e NATO-s në më shumë se një dekadë. Ajo është ambicioze dhe kjo është duke u kërkuar. Me rreth 36.000 trupa, më shumë se njëqind e dyzet avionë dhe gjashtëdhjetë anije, nga më shumë se 30 kombe.

Trident Juncture është element i trajnimit të Forcës së Reagimit të NATO-s për t'iu përgjigjur një game të gjerë të sfidave. Për të siguruar që ata mund të punojnë së bashku për t'u marrë me sfidat nga jugu apo nga lindja.

Ne jemi duke testuar skenare komplekse. Ne jemi duke testuar Forcat tona Ajrore, Tokësore Detare dhe Forcat Speciale. Ne jemi duke testuar komandantët tanë. Ne jemi duke testuar aftësinë tonë për të punuar së bashku dhe me shumë kombe partnere dhe shumë organizata të ndryshme. Nga ajo që kam parë sot, NATO është deri në provë.

Ndërsa qëllimi ynë është për trajnim dhe stërvitje, ne jemi edhe përmes këtij ushtrimi Trident Juncture duke dërguar një mesazh të qartë, popujve tanë dhe për çdo kundërshtar të mundshëm. NATO-ja nuk kërkon konfrontim. Por ne jemi të gatshëm për të mbrojtur të gjithë aleatët. Pra, Trident Juncture është një pjesë e rëndësishme e përshtatjes afatgjatë të NATO-s në një mjedis të ndryshuar dhe të ri të sigurisë, jostabiliteti dhe ekstremizmi në Afrikën e Veriut dhe Lindjen e Mesme, brutaliteti i ISIS, ndërhyrja ushtarake e Rusisë në Siri dhe në Mesdhe dhe veprimet e saj agresive në Ukrainë.

Në përgjigje të sfidave komplekse dhe kërcënimeve nga drejtime të ndryshme, Trident Juncture tregon se aftësitë e NATO-s janë reale dhe gati. Ne jemi në gjendje për të vepruar në një shkallë të madhe mbi një zonë të madhe. Ky ushtrim tregon gjithashtu se NATO është e angazhuar për transparencën dhe parashikueshmërinë. Ushtrimet tona janë të hapur për botën. Ne kemi ftuar vëzhgues ndërkombëtarë nga të gjitha vendet e OSBE-së dhe përtej, me ushtrimin. Jam i kënaqur të shoh se shumë prej tyre janë sot këtu. Pra, ata mund të shohin vetë se ajo që bëjmë është mbrojtëse. Ajo është proporcionale. Dhe kjo është plotësisht në përputhje me angazhimet tona ndërkombëtare. Kështu që jam i kënaqur të shoh se ky ushtrim është duke treguar forcën dhe unitetin e të gjithë aleancës.

Demonstrimi i përbashkët ushtarak

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, më 4 nëntor 2015 ndoqi një demonstrimin në Zonën e Trajnimit San Gregorio në Spanjë. Së bashku me të ishin të ministri spanjoll i Mbrojtjes Pedro Morenés, ambasadorë të Këshillit të Atlantikut të Veriut dhe komandantët e lartë ushtarakë aleatë. Forcat nga 12 aleatët e NATO-s kryen një operacion që përfshinte një peng shpëtimi, pastrimin e fushës së minuar dhe sulme të këmbësorisë. Sulme dhe ngarkesa të helikopterëve, duke përfshirë Apach të SHBA, Chinooks dhe Blackhawks që morrën pjesë gjithashtu, si dhe aeroplanë luftarakë që praktikuan mbështetje të ngushtë ajrore. Demonstrimet përfshinë vendosjen e mbi 500 trupave amerikane ajrore nga Divizioni Airborne 82, që fluturuan direkt nga baza e Fort Bragg, e Karolinës së Veriut dhe rënien me parashutë në terrenin e trajnimit në San Gregorio.

Trajnimi i forcave aleate gjatë stërvitjes Trident Juncture 2015 tregon se NATO është në gjendje të mbrojë të gjithë aleatët kundër çdo kërcënimi, tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, pas demonstrimit ushtarak të forcave aleate që punuan së bashku në Spanjë. “Trident Juncture tregon se aftësitë e NATO-s janë reale”, tha ai. Stoltenberg tha se “NATO është deri në provë”. Ai shtoi se “ndërsa qëllimi ynë është për të trajnuar dhe stërvitur, gjithashtu ne jemi duke u dërguar një mesazh të qartë, kombeve tona dhe për çdo kundërshtar të mundshëm. NATO nuk kërkon konfrontim, por ne jemi të gatshëm për të mbrojtur të gjithë aleatët”.

Trident Juncture tregon gjithashtu se NATO është e angazhuar për transparencë dhe parashikueshmëri, theksoi Sekretari i Përgjithshëm. NATO ka ftuar vëzhgues nga të gjitha vendet anëtare të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) dhe nga vende të tjera në mbarë botën për stërvitjen.

Stërvitja përfshiu më shumë se 230 njësi, më shumë se 140 avionë dhe më shumë se 60 anije.

Në fjalën e tij në ditën e vizitorëve të shquar në Trident Juncture 2015 në Zaragosa, Spanjë, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg tha se “Jemi duke shkuar për të parë shumë trupa që ushtrohen në shumë fusha të ndryshme dhe përmbytjen e sfidave të



ndryshme. Me më shumë se tridhjetë e gjashtë mijë trupa, mbi njëqind e dyzet avionë dhe më shumë se gjashtëdhjetë anije nga mbi tridhjetë vende të ndryshme. Kjo është me të vërtetë një shfaqje e madhe e aftësive tona, si dhe aftësive tona për të punuar së bashku”. Gjatë dy viteve të fundit, siguria e Evropës dhe mjedisi i sigurisë i Evropës ka ndryshuar dukshëm. “Ushtrimet si ky tregojnë se NATO qëndron e fortë. E gatshme për të mbrojtur vlerat tona, njerëzit tanë dhe territoret tona. Për sigurinë tonë është baza e çdo gjë ne e kemi dashur: demokracinë tonë, prosperitetin tonë dhe lirinë tonë”. Ai tha se “Ky ushtrim vë NATO-n dhe partnerët tanë në provë” duke falenderuar vendet pritëse dhe partnere të stërvitjes, organizatorët dhe shprehu mirënjohjen për BE dhe rolin e saj, organizatat dhe OJQ-të e tjera, si Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq etj. Stoltenberg theksoi se “Skenari i përballjes të trupave tona këtu nuk është i vërtetë. Por përfitimet, eksperiencia dhe

mësimet që ata do të mësojnë janë shumë reale. Kjo është arsyeja pse Trident Juncture është aq e rëndësishme. Kjo është arsyeja pse ne të gjithë mund të jemi të sigurt në forcën e vazhdueshme dhe elasticitetin e aleancës së NATO-s”

Aleatët dhe partnerët testuan me sukses ndërveprimin gjatë Trident Juncture 2015

Kryetari i Komitetit Ushtarak të

NATO-s, gjenerali i përgjithshëm Petr Pavel, morri pjesë gjithashtu në ditën e vizitorëve të shquar (Dita DV) në Zaragosa, Spanjë, së bashku me Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg, përfaqësues të Këshillit të Atlantikut të Veriut dhe Komitetit Usharak dhe zyrtarë të tjerë të lartë. Dita e DV u fokusua në komponentin tokësor të stërvitjes Trident Juncture 2015. Gjatë fjalës së tij përshëndetëse kryetari



duartrokiti Spanjën për bashkëpritjen e stërvitjes së bashku me Italinë dhe Portugalinë, si dhe për mbështetjen e saj të vazhdueshme në operacionet e NATO-s dhe misionet. “Jam mirënjohës për të gjitha përpjekjet që Spanja ka bërë për të akomoduar kërkesat e trajnimit të trupave të kombeve, për të përgatitur objektet tuaja të trajnimit dhe të stërvitjes dhe për të na pritur të gjithëve ne këtu sot”. Duke folur në Trident Juncture 2015, gjenerali Pavel përgëzoi të gjithë trupat që morrën pjesë dhe falënderoi të gjithë ata që kanë qenë pjesë e planifikimit dhe ekzekutimit të Trident Juncture 2015 për punën e tyre të madhe dhe përkushtimin. Kryetari veçanërisht falënderoi Komandën Aleate Tokësore për organizimin e demonstrimit të fuqishëm të aftësive dhe aseteve të Forcave Tokësore të NATO-s gjatë ushtrimit. Gjatë konferencës së shtypit gjenerali Pavel theksoi rëndësinë e Trident Juncture 2015 si një mënyrë për të përgatitur komandat dhe forcat të veprojnë së bashku në kohë paqe, krize dhe konflikti. Gjatë Trident Juncture, u testuan NRF të zgjeruara, VJTF, si dhe shumë koncepte dhe procedurat të reja. Gjatë stërvitjes dhe ekzekutimit të TRJE15, mësimet të rëndësishme u identifikuan dhe u nxorën dhe u shkëmbyen praktikat më të mira. Gjenerali Pavel deklaroi se, “ndërsa vendet e NATO-s kanë disa prej forcave të trajnuara më shumë në botë”, është pikërisht dhe ndoshta momenti që “gjatë këtyre llojeve të ushtrimeve që të gjitha mangësitë duhet të respektohen, dokumentohen dhe veçanërisht analizohen dhe korrigjohen”, me qëllim që vendet e NATO-s dhe vendet partnere të jenë të përgatitur, për t'u përballur me ndonjë kërcënim apo krizë që vjen nga çdo drejtim.

Stërvitja Trident Juncture që përfshiu 36.000 personel prej më shumë se 30 vendeve aleate dhe partnere që u zhvillua në të gjithë Italinë, Portugalinë, Spanjën, Oqeanin Atlantik, Detin Mesdhe demonstroi nivel të ri në rritje të NATO-s, të ambicies në konfliktin e përbashkët moderne pajisur me aftësinë dhe kapacitetin për të përmbytur sfidat e tanishme dhe të ardhshme të sigurisë të përshtatshme.

Pëgatiti: Mimoza Golikja

Forca Ajrore i bashkohet motos “Ndihmoni për ata që nuk janë si ju”

Ndihmoni për ata që nuk janë si ju”, nën këtë moto efektivat e Forcës Ajrore kanë dhënë kontributin e tyre në grumbullimin e ndihmave për fëmijët jetimë dhe të moshuarit e vetmuar. Nga Dega e BCU-s në Forcën Ajrore u organizua një fushatë sensibilizuese me efektivat e Forcës Ajrore në lidhje me këtë akt human. Kështu u bë e mundur që të grumbullohet një sasi e konsiderueshme kontributesh, kryesisht në ushqime dhe veshmbathje, të cilat do të ndikojnë sadopak në përmirësimin e gjendjes së kësaj shtrese të shoqërisë në të cilën ata ndodhen. Forca Ajrore gjithashtu ka mbështetur të gjitha nismat me Kryqin e Kuq Shqiptar, ku aktiviteti kryesor ka qenë dhe dhurimi i gjakut i cili u zhvillua gjatë muajit shtator. Forca Ajrore do të jetë e gatshme të bashkëpunojë edhe në të ardhmen për të ndihmuar njerëzit në nevojë.

